



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.160**

**9 dhjetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 480 datë 17.11.2011	Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore.....	7625
Ligj nr.10 481 datë 17.11.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9662, datë 18.2.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.....	7638
Ligj nr.10 482 datë 17.11.2011	Për një ndryshim në ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.....	7647
Ligj nr.10 483 datë 17.11.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.....	7648
Vendim i Kuvendit nr.141, datë 17.11.2011	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.....	7649
Vendim i Kuvendit nr.142, datë 17.11.2011	Për zgjedhjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.....	7650
Vendim i KM nr.772, datë 10.11.2011	Për lejimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave për objektet e parashikuara për t’u realizuar me fondet buxhetore.....	7651
Vendim i KM nr.782, datë 10.11.2011	Për krijimin e Komisionit Shtetëror, për organizimin e veprimtarive festive për “Vitin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.....	7651
Vendim i KM nr.784, datë 10.11.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Ura e Bujanit-Sopot, Tropojë.....	7652
Vendim i KM nr.789, datë 16.11.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.769, datë 15.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”.....	7654

Vendim i KM nr.791, datë 16.11.2011	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Brazilit, për përjashtimin e kërkesave për vizë.....	7655
Vendim i KM nr.792, datë 16.11.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Prezë, të qarkut të Tiranës.....	7657
Vendim i KM nr.793, datë 16.11.2011	Për dhënie fondi financiar shtesë bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës, për rikonstruksionin e pallatit nr.10, lagjja nr.6, rruga “M. Shkodrani”, Korçë, djegur nga zjarri.....	7658
Vendim i KM nr.794, datë 16.11.2011	Për rishpërndarje fondesh buxhetore, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, në buxhetin e vitit 2011, zëri “Shpenzime korrente” .....	7659
Vendim i KM nr.795, datë 16.11.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gavran” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	7660
Vendim i KM nr.796, datë 16.11.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë – Podgoricë, qarku Tiranë, bashkia Kamzë, komuna Bërxull.....	7661
Vendim i KM nr.797, datë 16.11.2011	Për një shtesë në vendimin nr.776, datë 4.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës ekonomike, në Elbasan” .....	7663
Vendim i KM nr.800, datë 16.11.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Përparim Hoxha.....	7663
Vendim i KM nr.801, datë 16.11.2011	Për shtyrjen e afatit të shpalljes dhe të botimit të njoftimit të fituesit e të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e saj të varësisë, si autoritete kontraktore.....	7664
Vendim i KM nr.802, datë 16.11.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.148, datë 11.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Martanesh, të qarkut të Dibrës” dhe për një shtesë në vendimin nr.523, datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Martanesh, të qarkut të Dibrës” .....	7665
Udhëzim i MPPT dhe MD nr.4728, datë 7.11.2011	Për miratimin e kontratës tip të administrimit të bashkëpronësisë..	7666

Vendim i GJK nr.50, datë 22.11.2011	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të plotë të vendimit të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut (KEDNJ).....	7671
Vendim i ERE nr.114, datë 16.11.2011	Për licencimin e shoqërisë “Diteko” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et në lumin “Zalli i Okshtunit”: “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë”.....	7675
Vendim i ERE nr.115, datë 16.11.2011	Për licencimin e shoqërisë “Diteko” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7676
Vendim i ERE nr.116, datë 16.11.2011	Për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec-et në lumin Zalli i Okshtunit”: Hec-et “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë” si burim i rinovueshëm energjie.....	7677
Vendim i ERE nr.117, datë 16.11.2011	Mbi ankandin mujor të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për muajin dhjetor 2011.....	7678
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Xheladin Arapaj.....	7678

**LIGJ**  
**Nr.10 480, datë 17.11.2011**

**PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE\***

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrimet e prodhuesve e të shpërndarësve, me qëllim që produktet e konsumatorit të vendosura në treg të jenë të sigurta, si dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

**Neni 2**  
**Fusha e veprimit**

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet e përkufizuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht mënyrave të shitjes, përfshirë këtu shitjen elektronike dhe atë në distancë. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për produktet, siguria e të cilave nuk është e rregulluar nga legjislacioni i veçantë.
2. Kur produktet janë objekt i kërkesave specifike të sigurisë, që rregullohen nga legjislacioni i veçantë, ky ligj zbatohet vetëm për aspektet dhe risqet ose kategoritë e risqeve, që nuk mbulohen nga legjislacioni i veçantë.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Produkt” është çdo substancë, artikull i fabrikuar ose send joushqimor, që mund të jetë i ri, i përdorur apo i riparuar, i parashikuar për t’u përdorur nga konsumatorët ose që mund të

---

\* Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën nr. 2001/95/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 3 dhjetor 2001 “Mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve”. Numri CELEX:32001L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.177, datë 15.1.2002, faqe 4-17.  
Rregulloren nr. 765/2008/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 “Mbi vendosjen e kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut lidhur me tregtimin e produkteve”, e cila shfuqizon rregulloren Nr. 339/93/KEE. Numri CELEX:32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 218, datë 13.8.2008, faqe 30-47.



përdoret prej tyre në kushte të arsyeshme e të parashikueshme edhe kur nuk është i parashikuar për ta, dhe që furnizohet ose bëhet i disponueshëm gjatë një veprimtarie tregtare. Këtu përfshihet edhe produkti që i furnizohet apo i bëhet i disponueshëm konsumatorit në kontekstin e ofrimit të një shërbimi nga ofruesit e shërbimit, kur ky produkt përdoret nga konsumatori.

Ky përkufizim zbatohet edhe për produktet e parashikuara për përdorim vetëm për profesionistë, në qoftë se këto produkte përfundojnë në tregun e konsumatorëve.

Ky përkufizim nuk zbatohet për:

a) produktet e përdorura, që vihen në dispozicion, si sende antike;

b) produktet, që duhen riparuar ose ndrequr përpara përdorimit, me kusht që furnizuesi të informojë me hollësi për këtë personin, të cilit i ofrohet produkti.

2. “Produkt i sigurt” është çdo produkt për konsumatorin, i cili, në kushte normale ose të arsyeshme, të parashikueshme përdorimi, përfshirë kohëzgjatjen dhe, sipas rastit, kërkesat për vënien në shërbim, për instalimin e për mirëmbajtjen, nuk paraqet ndonjë rrezik ose vetëm një shkallë minimale rreziku, të pajtueshëm me përdorimin e produktit, që vlerësohet i pranueshëm dhe në përputhje me nivelin e lartë të mbrojtjes e të sigurisë së personave, duke marrë parasysh, në veçanti, elementet e mëposhtme:

a) karakteristikat e produktit, përfshirë përbërjen, paketimin, udhëzimet për montimin dhe, kur është e zbatueshme, instalimin e mirëmbajtjen;

b) efektin ndaj produkteve të tjera, kur, në mënyrë të arsyeshme, parashikohet se do të përdoret me produkte të tjera;

c) paraqitjen e produktit, etiketimin, çdo paralajmërim e udhëzim për përdorimin dhe vënien e tij në dispozicion, si dhe çdo shenjë apo informacion tjetër për produktin;

ç) kategoritë e konsumatorëve të rrezikuar nga përdorimi i mallit, veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit.

3. “Produkt i rrezikshëm” është çdo produkt, i cili nuk është në përputhje me përkufizimin e termit “produkt i sigurt”, i parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

4. “Risk serioz” është rreziku, i cili kërkon ndërhyrjen e shpejtë të organeve publike edhe nëse efektet e tij nuk janë të menjëhershme.

5. “Prodhues” është:

a) fabrikuesi i produktit, kur është i vendosur në Shqipëri, dhe çdo person tjetër që deklarohet si fabrikues, duke vënë në produkt emrin e vet, markën e tregtimit ose marka të tjera dalluese;

b) përfaqësuesi në Republikën e Shqipërisë i fabrikuesit, kur fabrikuesi nuk është i vendosur në Shqipëri;

c) importuesi i produktit në mungesë të fabrikuesit apo përfaqësuesit të tij në Shqipëri;

ç) persona të tjerë, të përfshirë në zinxhirin e shpërndarjes, për sa kohë që veprimtaritë e tyre mund të ndikojnë në sigurinë e një produkti të vendosur në treg.

6. “Fabrikues” është çdo person fizik ose juridik, i cili fabrikon/prodhon një produkt ose që ka një produkt të disenjuar ose të prodhuar dhe e tregon këtë produkt nën emrin apo markën e tij tregtare.

7. “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i vendosur në Shqipëri, i cili vendos në tregun shqiptar një produkt nga një vend tjetër.

8. “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e shpërndarjes, veprimtaria e të cilit nuk ndikon në karakteristikat e sigurisë së produktit.

9. “Ndalim tregtimi” është çdo masë për të parandaluar shpërndarjen, ekspozimin dhe ofrimin e produktit të rrezikshëm te konsumatori.

10. “Kthim i produktit” është çdo masë për kthimin mbrapsht të produkteve të rrezikshme që ndërkohë janë bërë të disponueshme te konsumatori nga prodhuesi ose shpërndarësi.

11. “Standard shqiptar” është një dokument vullnetar, i krijuar me konsensus dhe i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, në përputhje me kërkesat e ligjit për standardizimin, që siguron, për përdorim të njëjtë dhe të vazhdueshëm, rregulla, udhëzime ose karakteristika për veprimtaritë ose rezultatet e tyre, për arritjen e një shkalle optimale të rregullsisë në një kontekst të dhënë. Standardet shqiptare shënohen me “SSH”.

12. “Standard i harmonizuar shqiptar” është një standard shqiptar, që transponon një standard të harmonizuar europian, në mbështetje të këtij ligji, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e tregtisë, në bashkërendim me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

13. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e tregtisë.

14. “Ministër” është ministri përgjegjës për çështjet e tregtisë.

15. “Ministria përgjegjëse” është ministria përgjegjëse për fushën përkatëse.

16. “Mbikëqyrje e tregut” janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, për të garantuar që produktet janë në përputhje me kërkesat ligjore në lidhje me to dhe nuk rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose aspektet e tjera të mbrojtjes së interesit publik.

17. “Strukturë përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut” është struktura përgjegjëse për kryerjen e mbikëqyrjes së tregut.

## KREU II SIGURIA E PËRGJITHSHME

### Neni 4

#### **Kërkesa e përgjithshme e sigurisë dhe prezumimi i sigurisë**

1. Prodhuesit janë të detyruar të vendosin në treg vetëm produkte të sigurta.

2. Një produkt prezumohet i sigurt nëse është në përputhje me një ndër standardet e harmonizuara shqiptare, që mbulojnë risqet dhe kategoritë përkatëse të riskut të produktit në fjalë.

3. Në mungesë të rregullave specifike dhe në rrethana të tjera, përveç nga sa përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, konformiteti i produktit me kërkesën e përgjithshme të sigurisë vlerësohet duke pasur parasysh elementet e mëposhtme:

a) standardet vullnetare shqiptare, që transpozojnë standardet përkatëse europiane, në dallim nga ato të parashikuara në pikën 2 të këtij neni;

b) standarde të tjera shqiptare apo standarde të tjera kombëtare të adoptuara nga vende anëtare të Bashkimit Europian, ku produktet janë vendosur në treg;

c) kode/udhëzues të hartuar nga autoritete publike apo organizata profesionale për praktikat më të mira për sigurinë e produkteve në sektorin përkatës;

ç) rekomandime të Komisionit Europian për vendosjen e udhëzimeve për vlerësimin e sigurisë së produkteve;

d) pritshmërinë e arsyeshme të konsumatorëve për sigurinë e produktit;

dh) nivelin e teknologjisë dhe artizanatit.

### Neni 5

#### **Standardet e harmonizuara shqiptare**

Për qëllim të këtij ligji, standardet e harmonizuara shqiptare hartohen si më poshtë:

1. Këshilli i Ministrave përcakton kërkesat, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë që produktet, të cilat përputhen me këto standarde, të përmbushin kërkesën e përgjithshme të sigurisë.



2. Bazuar në këto kërkesa, Organizmi Kombëtar i Standardizimit, mbështetur në legjislacionin në fuqi për standardizimin, harton dhe adopton standardet që plotësojnë kërkesën e përgjithshme të sigurisë. Lista e këtyre standardeve referuese publikohet në Fletoren Zyrtare.

3. Nëse një standard nuk siguron më përputhjen me kërkesën e përgjithshme të sigurisë, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e tregtisë, anulon referencën ndaj këtij standardi dhe e heq atë nga lista e publikuar për standardet e referencës.

## Neni 6

### Detyrime të tjera të prodhuesit e të shpërndarësit

1. Prodhuesit kanë detyrimin:

a) t'u sigurojnë konsumatorëve të gjithë informacionin përkatës në gjuhën shqipe, për t'u mundësuar vlerësimin e riskut të qenësishëm në një produkt gjatë periudhës normale apo të arsyeshme të parashikueshme të përdorimit të tij, kur risqet nuk janë menjëherë evidente pa paralajmërimin e përshtatshëm;

b) të marrin masat paraprake për parandalimin ose minimizimin e këtyre risqeve.

Prania e paralajmërimit nuk çliron prodhuesin nga detyrimi për përputhshmërinë me kërkesat e tjera, të vendosura në këtë ligj.

2. Prodhuesit, brenda kufijve të veprimtarisë së tyre përkatëse, duhet të ndërmarrin masa në përpjesëtim me karakteristikat e produkteve që ata furnizojnë, duke mundësuar që:

a) të kenë informacionin e duhur për risqet, që mund të paraqesin këto produkte;

b) të ndërmarrin veprimet e duhura, për të shmangur këto risqe, përfshirë, nëse është e nevojshme, njoftimin në mënyrë të përshtatshme dhe efektive të konsumatorëve, ndalimin e tregtimit, tërheqjen nga tregu apo kthimin e produkteve nga konsumatorët.

3. Në masat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni përfshihen, ndërmjet të tjerave:

a) paraqitja e të dhënave në etiketën mbi produkt apo paketimin e tij për identitetin, adresën dhe hollësi të tjera për prodhuesin, si dhe e të dhënave për vetë produktin ose, sipas rastit, e të dhënave për grupin e produkteve të cilit i përket;

b) kryerja e testeve të mostrave të produkteve të tregtuara, hetimi, mbajtja e një regjistri ankesash, si dhe vënia në dijeni e shpërndarësve për një kontroll të tillë.

Masat e parashikuara në shkronjën "b" të kësaj pike mund të ndërmerren vullnetarisht nga prodhuesit ose me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut (më poshtë struktura përgjegjëse), sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Kthimi i produktit zbatohet si hap i fundit, kur:

a) masat e tjera nuk mjaftojnë për të parandaluar risqet;

b) vetë prodhuesit e konsiderojnë të nevojshme;

c) prodhuesit janë të detyruar ta bëjnë këtë në vijim të një mase të marrë nga struktura përgjegjëse.

5. Prodhuesit janë përgjegjës për të siguruar që i gjithë informacioni për produktet e tyre është i saktë, i plotë dhe në përputhje me rregullat e zbatuara.

6. Shpërndarësit duhet të veprojnë për të siguruar përputhshmërinë e produkteve me kërkesën e përgjithshme të sigurisë, sipas këtij ligji, veçanërisht duke mos furnizuar produkte për konsumatorët, për të cilët ata dinë ose duhet të dinë në bazë të nivelit të tyre profesional dhe të dhënave që zotërojnë, se nuk janë në përputhje me këto kërkesa.

7. Brenda kufijve të veprimtarisë së tyre përkatëse, shpërndarësit janë të detyruar të marrin pjesë në monitorimin e sigurisë së produkteve të vendosura në treg, veçanërisht duke u përcjellë furnizuesve të tyre dhe konsumatorëve informacionin për risqet e produktit, duke mbajtur dhe duke dhënë informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë e origjinës së produktit, si dhe duke

bashkëpunuar me prodhuesit dhe strukturën përgjegjëse në veprimet e ndërmarra për shmangien e risqeve.

8. Kur prodhuesit dhe shpërndarësit dinë apo duhet të dinë, në bazë të nivelit të tyre profesional dhe të të dhënave që zotërojnë, se një produkt që ata e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me kërkesën e sigurisë së përgjithshme dhe paraqet risk për konsumatorët, ata informojnë menjëherë strukturën përgjegjëse, duke dhënë hollësi dhe veçanërisht të dhëna për veprimet e ndërmarra, për parandalimin e rrezikut ndaj konsumatorëve.

Në rastin e rreziqeve serioze ky informacion përfshin të paktën elementet e mëposhtme:

- a) identifikimin e saktë të produktit apo të grupit të produkteve të cilit i përket;
- b) një përshkrim të plotë të riskut që paraqet produkti;
- c) të gjithë informacionin e disponueshëm përkatës për gjurmimin e produktit;
- ç) përshkrimin e veprimeve të ndërmarra për parandalimin e riskut ndaj konsumatorëve.

9. Prodhuesit dhe shpërndarësit, brenda kufijve të veprimtarisë së tyre përkatëse, bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse, me kërkesë të kësaj të fundit, për veprimet e ndërmarra për shmangien e risqeve, që mbartin produktet që ata shpërndajnë apo kanë shpërndarë.

#### Neni 7

#### Masa mbrojtëse për sigurinë

1. Përputhshmëria e një produkti me përcaktimet e dhëna në pikat 2 e 3 të nenit 4 të këtij ligji nuk ndalon strukturën përgjegjëse të marrë masa për të vendosur kufizime për bërjen e disponueshme të produktit në treg, për ndalimin e tregtimit ose për kthimin e produktit kur ka evidenca se, pavarësisht një përputhshmërie të tillë, produkti është i rrezikshëm.

2. Masa të tilla i komunikohen paraprakisht prodhuesit apo, sipas rastit, shpërndarësit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të kontrollit, i cili, sipas rastit, informohet për ndreqjet e mundshme sipas legjislacionit dhe për afatin kohor brenda të cilit duhen kryer.

3. Struktura përgjegjëse njofton paraprakisht palët e interesuara për masat e referuara në pikën 1 të këtij neni, dhe u jep atyre mundësinë për të paraqitur komentet e tyre me shkrim brenda 10 ditëve para miratimit të këtyre masave, me përjashtim të rasteve të marrjes së masave, për shkak të urgjencës. Në rastet e një urgjence të tillë, struktura përgjegjëse i jep mundësinë prodhuesit të dëgjohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe pas kësaj masat e marra rishikohen menjëherë.

4. Struktura përgjegjëse, kur e gjykon të mundshme dhe të arsyeshme, kërkon fillimisht të arrihet përmbushja e përputhshmërisë me kërkesat e këtij ligji në mënyrë vullnetare nga prodhuesit apo shpërndarësit.

#### Neni 8

#### Mospërputhja e një produkti me kërkesat e këtij ligji

Kur një produkt, i cili nuk i përmbush kërkesat e këtij ligji apo të akteve nënligjore në zbatim të tij, është pjesë e një grupi, sasi apo ngarkese të produkteve të së njëjtës klasë, tipi ose lloji, prezumohet, nëse nuk provohet e kundërta, se të gjitha produktet e këtij grupi, sasi apo ngarkese nuk janë në përputhje me këto kërkesa.

#### KREU III

#### MBIKËQYRJA E TREGUT

#### Neni 9

#### Strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut

1. Mbikëqyrja e zbatimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij ligji kryhet nga rrjeti i strukturave përgjegjëse dhe mbështetet nga autoritetet doganore siç parashikohet nga ky ligj.





2. Strukturat përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mbikëqyrjes së tregut, procedurat standarde të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, si dhe produktet që do të mbikëqyrë secila prej këtyre strukturave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 10

#### **Të drejtat dhe detyrimet e strukturës përgjegjëse**

Struktura përgjegjëse ka këto të drejta dhe detyrime:

a) të ndalojë, me urdhër me shkrim, vendosjen në treg të çdo produkti, i cili është i rrezikshëm ose nuk përputhet me dispozitat e këtij ligji apo aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe të paraqesë masat plotësuese të kërkuara për të siguruar se ndalimi është në përputhje me to;

b) të kërkojë, me urdhër me shkrim, tërheqjen e menjëhershme nga tregu, ndalimin e menjëhershëm të tregtimit të produkteve të rrezikshme që janë të disponueshme në treg dhe të lajmërojë konsumatorët për rrezikun që ato paraqesin;

c) të urdhërojë me shkrim ose, nëse është e përshtatshme, të organizojë së bashku me prodhuesit dhe shpërndarësit kthimin e produkteve të pasigurta nga konsumatorët dhe, nëse gjykohet e nevojshme, të urdhërojë asgjësimin/shkatërrimin e produkteve të tilla në kushte të përshtatshme;

ç) të ndalojë me urdhër me shkrim furnizimin, ofrimin ose ekspozimin e produkteve ose grupprodukteve, kur gjykohet nga struktura përgjegjëse se ekzistojnë baza të arsyeshme për të dyshuar se produkti është i rrezikshëm, për aq kohë sa është e nevojshme për kryerjen e testeve. Bazë për dyshim përbëjnë edhe njoftimet nga sistemet e shpejta të këmbimit të informacionit për produktet e rrezikshme në nivel evropian ose më gjerë, ankesat apo çdo lloj informacioni që mund të përbëjë bazë të arsyeshme për dyshim;

d) të marrë masa të tilla, që konsiderohen të nevojshme për të eliminuar ose për të parandaluar praktikën, të cilat janë të dëmshme për sigurinë e produktit;

dh) për çdo produkt që mund të paraqesë risk në kushte të caktuara:

i) të urdhërojë me shkrim vendosjen e shënimit përkatës e të përshtatshëm në produkt për paralajmërime, të formuluar në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, për risqet që mund të paraqesë;

ii) të bëjë tregtimin e tij, objekt të kushteve paraprake, të vendosura nga kjo strukturë përgjegjëse, me qëllim garantimin e sigurisë së përgjithshme të produktit;

e) për çdo produkt që mund të paraqesë risk për persona të caktuar, të urdhërojë që atyre t'u jepen paralajmërimet në kohën e duhur dhe në formën e përshtatshme, përfshirë edhe publikimin e paralajmërimeve të veçanta;

ë) të kryejë në një shkallë të mjaftueshme deri në fazën përfundimtare, duke përdorur të gjitha aktivitetet e kontrollit të produktit, përfshirë inspektimet, analizat, ekzaminimet ose dhe hetime të tjera për karakteristikat e sigurisë së produkteve, edhe pasi produkte të tilla kanë qenë të vendosura në treg si të sigurta;

f) të kërkojë të gjitha informacionet e nevojshme nga pala e interesuar;

g) të marrë mostra të produkteve për t'ia nënshtruar kontrollovet të sigurisë apo testeve në laboratorë të akredituar që plotësojnë kriterin e paanshmërisë për këtë produkt. Në qoftë se testimet e mostrave tregojnë se produkti nuk është në përputhje me kërkesën e përgjithshme të sigurisë, shpenzimet e testeve i ngarkohen prodhuesit ose, sipas rastit, ofruesit të shërbimit. Në rast të kundërt, shpenzimet mbulohen nga struktura përgjegjëse;

gj) të publikojë kopje të urdhrave të lëshuar sipas çdo dispozite të këtij ligji.

## Neni 11

### Masa të marra nga struktura përgjegjëse

1. Kur struktura përgjegjëse merr masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, veçanërisht për shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, duhet të zbatojë masat në përpjesëtim me riskun dhe duke marrë parasysh parimin parandalues.

Struktura përgjegjëse organizon ose urdhëron masat e parashikuara në nenin 10 shkronjat “b” dhe “c” të këtij ligji, nëse veprimi i ndërmarrë nga prodhuesit dhe shpërndarësit për përmbushjen e detyrimeve të tyre është i pakënaqshëm ose i pamjaftueshëm. Kthimi i produkteve nga konsumatorët ndërmerret si hap i fundit.

2. Në rastin e produkteve që paraqesin një risk serioz, struktura përgjegjëse duhet menjëherë të marrë masat përkatëse të përmendura në nenin 10 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” “dh” dhe “e” të këtij ligji. Ekzistenca e një risku serioz përcaktohet nga struktura përgjegjëse, duke vlerësuar çdo rast individual, në bazë të cilësive të tij.

3. Ngarkohet ministri për nxjerrjen e udhëzimit për metodat/mënyrën e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut serioz.

4. Struktura përgjegjëse informon ministrinë përgjegjëse për marrjen e masave, në përputhje me parashikimet e neneve 10 dhe 11 të këtij ligji, si dhe arsyet për këtë veprim.

5. Masat, referuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 10 të këtij ligji, merren edhe në rastet e vendimeve të Komisionit Europian për ndalimin e tregtimit apo kthimin e produkteve përkatëse.

6. Masat, që merren nga struktura përgjegjëse, drejtohen, sipas rastit, te:

a) prodhuesi;

b) shpërndarësit, brenda sferës së veprimtarisë përkatëse të tyre, dhe në veçanti, pala përgjegjëse për fazën e parë të shpërndarjes në treg;

c) çdo person tjetër, kur është e nevojshme, me qëllim bashkëpunimin në veprimin e ndërmarrë për të shmangur rreziqet që rrjedhin nga produkti.

## Neni 12

### Sistemi për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për:

a) krijimin e sistemeve dhe përcaktimin e procedurave për shkëmbimin e informacionit me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare në çështjet e sigurisë së produkteve;

b) përcaktimin e procedurave për të lejuar shkëmbimin e shpejtë të informacionit për sigurinë e produktit;

c) përcaktimin e formave dhe metodave të njoftimit, bashkëpunimit për çështjet e sigurisë së produktit me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, qoftë në baza shumëpalëshe, rajonale ose të tjera;

ç) krijimin e sistemeve, përcaktimin e procedurave për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin administrativ për sigurinë e produkteve ndërmjet institucioneve shtetërore, publike, në varësi të Këshillit të Ministrave.

## Neni 13

### Vendime për riskun serioz

Këshilli i Ministrave miraton masat në nivel kombëtar, për ndalimin e tregtimit, importit dhe eksportit të produkteve që paraqesin risk serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, në rastet kur ky risk nuk mund të eliminohet vetëm me masat e përmendura në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.



## Neni 14

### Kompetencat e inspektorit

1. Çdo inspektor i autorizuar me shkrim nga struktura përgjegjëse, kur ka baza të arsyeshme për të besuar se mbahen ose gjenden produkte të rrezikshme në ndonjë qendër prodhimi, magazinimi apo tregtimi, përveç vendeve për qëllime strehimi, ka të drejtë:

- a) të hyjë në këto qendra dhe të kryejë aty çdo inspektim që mund të jetë i nevojshëm;
- b) të sekuestrojë çdo produkt të gjetur aty, i cili rezulton produkt i pasigurt.

2. Nëse inspektori ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se produkte të tilla të rrezikshme mund të hiqen, shkatërrohen, ai mund të autorizojë me shkrim zyrtarë publikë për të ushtruar, në lidhje me subjekte të tilla, ndonjë nga kompetencat e përmendura në këtë nen.

3. Hyrja dhe kontrolli në qendrat e prodhimit, të magazinimit e të tregtimit apo ndërmarrjet do të kryhet brenda orarit normal të punës. Në rast se inspektori ka arsye për të besuar se vonesa mund të shkaktojë humbjen ose shuarjen e ndonjë prove ose përndryshe mund të sjellë pasojë në rezultatin e kërkimit, kontrolli mund të kryhet jashtë orarit të punës.

4. Gjatë hyrjes dhe kontrollit, sipas dispozitave të kësaj pjese të ligjit, inspektori mund të kërkojë mbështetjen e Policisë së Shtetit.

5. Kur është e nevojshme për kryerjen e duhur të funksioneve të sipërpërmendura, inspektori mund:

a) të marrë një mostër të çdo produkti apo të çdo materiali që përdoret në përgatitjen, prodhimin ose montimin e një produkti të tillë;

b) të hyjë forcërisht dhe të heqë çdo pengesë për hyrjen në qendra prodhimi, magazinimi, tregtimi për të kërkuar ose konfiskuar produkte, kur has në rezistencë nga prodhuesit apo shpërndarësit;

c) të kërkojë nga çdo person që kryen një veprimtari tregtare ose çdo i punësuar të vërë në dispozicion çdo libër apo dokument, përfshirë edhe ato të ruajtura në një kompjuter ose në çdo rrjet tjetër të informacionit për tregtinë ose biznesin dhe për të marrë kopje të tyre;

ç) të sekuestrojë dhe të marrë çdo mall, mostër të tyre apo materiale të tjera, të cilat janë të destinuara për shitje ose janë shitur, me qëllim për të vërtetuar nëse është kryer një shkelje e këtij ligji;

d) të sekuestrojë dhe të ndalojë çdo mall, mostër apo material ose dokument, për qëllime të mbledhjes së evidencave, për përcaktimin e shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) kur është e nevojshme, të kërkojë nga çdo person, që kryen veprimtari tregtare ose çdo i punësuar, hapjen e çdo konteineri ose makine shitëse ambulante. Në rast mospërbushjeje të kërkesës, inspektori i autorizuar mund të kryejë vetë këtë veprim, nëse është e nevojshme, duke thyer konteinerin ose makinën;

e) kur inspektori ka baza të arsyeshme për të besuar se prodhuesi, shpërndarësi apo tregtari i një aktiviteti tregtar nuk plotëson ndonjë dispozitë të këtij ligji ose të akteve nënligjore në zbatim të tij, mund t'i njoftojë ata me shkrim, duke përcaktuar:

i) dispozitën/dispozitat që nuk është/janë zbatuar dhe duke përcaktuar çështjet që përbëjnë shkeljen apo mosplotësimin;

ii) masat ndreqëse që kërkohen për t'u ndërmarrë dhe periudhën kohore.

#### Neni 15

##### **Inspektimi i produkteve**

1. Për qëllime të këtij ligji, inspektori mund të inspektojë çdo produkt, i cili:

a) është shitur, shitet apo ofrohet për shitje ose çdo konsumim apo përdorim për konsumatorët;

b) është në zotërim ose nën kontrollin e një prodhuesi a shpërndarësi ose është i depozituar apo i shpërndarë te ndonjë person për qëllime të shitjes ose të përgatitjes për shitje, kudo që produkti të gjendet.

2. Inspektori, gjatë inspektimit në qendra prodhimi/ndërmarrje, për arsye të çdo dispozite të kësaj pjese të ligjit, mund të shoqërohet nga persona të tjera ndihmës të autorizuar dhe mund të marrë me vete pajisje/produkte të tilla, që ai i konsideron të nevojshme.

#### Neni 16

##### **Hartimi dhe njoftimi i procesverbalit**

1. Në përfundim të kontrollit, inspektori/inspektorët i/e autorizuar harton/hartojnë dhe firmos/firmosin procesverbalin, në të cilin shënohen identiteti i kundërvajtësit dhe lista e gjetjeve faktike, lloji i kundërvajtjes, si dhe mënyra/lloji i kontrollit/inspektimit. Procesverballi hartohet dhe në rastin kur nuk ka kundërvajtje.

2. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet operatorit ekonomik përkatës brenda 5 ditëve pune nga data e përfundimit të kontrollit. Operatori ekonomik, brenda 10 ditëve pune pas marrjes së procesverbalit, ka të drejtën të paraqesë komentet e tij për konstatimet e dhëna në këtë procesverbal, me përjashtim të rasteve urgjente për riskun serioz, referuar në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

#### Neni 17

##### **Sekuestrimi i produkteve**

1. Në rastet kur inspektori sekuestron ndonjë produkt, dokumente ose regjistrime të tjera gjatë ushtrimit të funksioneve të tij sipas nenit 14 të këtij ligji, ai njofton personin, të cilit i është kryer sekuestrimi, dhe i jep vërtetimin përkatës.

2. Në rastin e produkteve të sekuestruara nga një makinë automatike shitjeje, inspektori informon personin, emri dhe adresa e të cilit janë deklaruar në këtë makinë, si pronar i saj, ose pronarin apo qiramarrësin e pronës/godinës, në të cilën është vendosur makina, kur nuk është deklaruar emri dhe adresa e personit që e ka vendosur atë.

#### Neni 18

##### **Sekreti profesional**

Ruajtja e sekretit profesional nuk interpretohet si kufizim për strukturën përgjegjëse, në komunikimin me konsumatorin për gjetjet, si rezultat i shqyrtimit të ankesës së tij.

#### Neni 19

##### **Dhënia e informacionit**

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të japin në mënyrë të qartë, të vërtetë, të saktë dhe jo të mangët të gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar nga struktura përgjegjëse, sipas dispozitave të këtij ligji.



## Neni 20 Njoftimi me shkrim

1. Në rastet kur inspektori ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se një produkt nuk është i sigurt ose mund të shkaktojë dëmtime, ai mund t'i japë prodhuesit ose shpërndarësit një njoftim me shkrim, duke e urdhëruar atë që për një periudhë kohe të caktuar produkti nuk do të përdoret, nuk do të shitet, nuk do të ofrohet për shitje apo tregtim ose nuk do të lëvizet, përveçse në vende të tilla, siç janë specifikuar në njoftim.

2. Sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dhënia e njoftimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, struktura përgjegjëse duhet që:

- a) të tërheqë njoftimin, referuar në pikën 1 të këtij neni, nëse produkti rezulton i sigurt;
- b) të ndalojë përdorimin ose shitjen, të urdhërojë sekuestrimin dhe konfiskimin, si dhe ruajtjen e produktit në vende të tilla të specifikuara me shpenzimet e prodhuesit, në rastin kur produkti rezulton i rrezikshëm.

3. Kryerja e procedurës të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, në rastin kur analizat duhen kryer në laboratorë të specializuar jashtë vendit, realizohet brenda 5 ditëve pune nga marrja e përgjigjes së testit.

## Neni 21 Masa të tjera për produkte të rrezikshme

Në rastin e produkteve të rrezikshme, struktura përgjegjëse në bashkëpunim me strukturat përkatëse në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, mund të urdhërojë që një produkt i tillë të shkatërrohet, të magazinohet ose atij t'i ndryshohet qëllimi i përdorimit, me shpenzimet e prodhuesit.

## Neni 22 Masat paralajmëruese dhe rregulluese për kundërvajtjet ndaj këtij ligji

Në rastet e shkeljeve që mund të rregullohen dhe nuk përbëjnë risk serioz, struktura përgjegjëse mund të kërkojë me shkrim nga personi përgjegjës marrjen e masave për shmangien, rregullimin apo ndreqjen e tyre, si dhe e paralajmëron për mospërsëritjen e shkeljeve të tilla.

## Neni 23 Politika e mbikëqyrjes së tregut

1. Ministri përgjegjës harton politikat e përgjithshme të mbikëqyrjes së tregut për zbatimin efektiv të këtij ligji.

2. Përgjegjësitë kryesore të ministrisë përgjegjëse janë si më poshtë:

- a) studimi dhe paraqitja e propozimeve për hartimin dhe zhvillimin e politikës për mbikëqyrjen e tregut;
- b) përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore për çështjet që lidhen me mbikëqyrjen e tregut;
- c) marrja e masave koordinuese me strukturën përgjegjëse për zbatimin e dokumenteve strategjike në fushën e mbikëqyrjes së tregut;
- ç) mbledhja e informacionit për produktet e rrezikshme ose potencialisht të rrezikshme nga struktura përgjegjëse dhe shkëmbimi i këtij informacioni me ministrinë përgjegjëse për tregtinë;
- d) vlerësimi periodik i veprimtarive të mbikëqyrjes së tregut një herë në 6 muaj;

dh) monitorimi i zbatimit të programeve të mbikëqyrjes sektoriale, sipas kategorive të produkteve ose rreziqeve dhe monitorimi i veprimtarive të mbikëqyrjes, i gjetjeve dhe rezultateve;

e) rishikimi periodik dhe vlerësimi i veprimtarive të mbikëqyrjes së tregut, si dhe efektiviteti i tyre.

3. Ministria përgjegjëse, në kryerjen e funksioneve të dhëna në pikën 2 të këtij neni, mbështetet nga Këshilli Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve, i krijuar sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve.

4. Ministria mund të përgatisë dhe të publikojë një listë, ku identifikohen:

a) produkte të cilat janë të rrezikshme;

b) prodhuesit dhe shpërndarësit e produkteve të tilla;

c) ata prodhues, shpërndarës apo persona të tjerë, praktikant ose veprimtaritë e të cilëve në lidhje me produkte të veçanta mund të ndikojnë negativisht në interesat e konsumatorëve;

ç) çdo çështje tjetër që mund të ndikojë negativisht në sigurinë e konsumatorëve.

#### Neni 24

### **Kontrolli i produkteve që hyjnë në tregun shqiptar**

1. Autoritetet doganore kryejnë kontrolle të përshtatshme për karakteristikat e produkteve në një shkallë të mjaftueshme, përpara se këto produkte të lejohen për qarkullim të lirë.

2. Doganat pezullojnë zhdoganimin e një produkti për qarkullim të lirë, kur gjatë kontrolleve të përmendura në pikën 1 të këtij neni është konstatuar ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) produkti paraqet në mënyrë të dukshme një risk serioz për shëndetin, sigurinë, mjedisin ose çdo interes tjetër publik, përmendur në këtë ligj;

b) produkti nuk është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit përkatës shqiptar ose nuk është i markuar në përputhje me atë legjislacion;

c) njoftohen nga ministria/ministritë përgjegjëse për pezullimin e zhdoganimit të produkteve të caktuara, në bazë të vendimeve të Komisionit Europian për ndalimin e tregtimit a kthimin e produkteve apo nga njoftimet e sistemeve të shkëmbimit të shpejtë të informacionit të vendeve të BE-së për produktet e rrezikshme.

3. Autoritetet doganore për çdo pezullim, në kuptim të këtij ligji, njoftojnë brenda 24 orëve strukturën përgjegjëse, përmes mjeteve të përshtatshme të komunikimit.

4. Struktura përgjegjëse heton më tej këtë çështje dhe njofton brenda 3 ditëve pune një nga vendimet e mëposhtme:

a) zhdoganimin;

b) ndalimin e përkohshëm të zhdoganimit deri në përfundimin e kontrolleve të duhura;

c) ndalimin e zhdoganimit, në qoftë se kjo strukturë, në përputhje me pikën 5 të nenit 11 të këtij ligji, është informuar se produkti është i rrezikshëm ose kur ai nuk është në përputhje me këtë ligj.

5. Në rast se struktura përgjegjëse njofton zhdoganimin ose nuk arrin të njoftojë brenda afatit kohor prej 3 ditëve pune, produkti zhdoganohehet nga autoritetet doganore, me kusht që të gjitha kërkesat e tjera dhe formalitetet për lejimin të jenë plotësuar.

6. Pas përfundimit të kontrolleve, referuar në pikën 4 shkronja “b” të këtij neni, struktura përgjegjëse u njofton menjëherë autoriteteve doganore, respektivisht:

a) zhdoganimin;

b) ndalimin e zhdoganimit kur produkti është gjetur i rrezikshëm ose në mospërputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

7. Zhdoganimi mund të shoqërohet me urdhër nga struktura përgjegjëse së bashku me një ose më shumë prej masave administrative, të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.

8. Në qoftë se struktura përgjegjëse vendos ndalimin e zhdoganimit, autoritetet doganore



përfshijnë në faturat tregtare, që shoqërojnë produktin, çdo dokument tjetër shoqërues, ose në sistemin e përpunimit të të dhënave, kur përpunimi i të dhënave bëhet në formë elektronike, nënshkrimin e mëposhtëm:

“Nuk autorizohet zhdoganimi për qarkullim të lirë në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij ligji”.

Në këtë rast struktura përgjegjëse mund të urdhërojë shkatërrimin e produktit ose kthimin e tij në vendin e origjinës, si dhe notifikon këtë masë pranë Autoritetit Kombëtar të Notifikimit në OBT, në përputhje me legjislacionin në fuqi për standardizimin.

#### KREU IV KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

##### Neni 25

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenin 6 pika 1 shkronja “a” dhe pika 3 shkronja “a”, si dhe moszbatimi i masave referuar në nenin 10 shkronjat “dh” nëndarja “i” dhe “e” të këtij ligji, me gjobë 200 000 lekë;

2. Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenin 6 pika 1 shkronja “b”, pika 2 shkronja “b”, pikat 6 e 7, në nenin 10 shkronjat “c”, “dh” nëndarja “ii” dhe “f” të këtij ligji, me gjobë 1 për qind të xhiros vjetore totale të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 300 000 lekë.

3. Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenin 6 pikat 8 e 9 të këtij ligji, me gjobë 2 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 400 000 lekë;

4. Shkeljet e dispozitave të parashikuara në nenin 4 pika 1, si dhe moszbatimi i masave referuar në nenin 10 shkronjat “a” e “b” dhe 21 të këtij ligji me gjobë 3 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 500 000 lekë.

5. Shkelja e dispozitave apo moszbatimi i masave referuar në nenin 6 pika 4 shkronja “c” dhe pika 5, në nenin 14 pika 1, në nenin 19, në nenin 20 pika 1 dhe në nenin 22 të këtij ligji, me gjobë 300 000 lekë.

6. Shkelja e masave të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji me gjobë 300 000 lekë.

##### Neni 26

Shkeljet me karakter administrativ verifikohen dhe dënohen nga struktura përgjegjëse.

##### Neni 27

Inspektori/inspektorët i/e autorizuar, që ka/kanë kryer kontrollin, merr/marrin vendim brenda 30 ditëve pune nga data e njoftimit të procesverbalit operatorit ekonomik që ka kryer shkeljen.

##### Neni 28

##### **Ankimi**

1. Ankimi administrativ kundër vendimit për shkeljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ kundër vendimit që parashikon dënim me gjobë, si dhe masa të tjera shoqëruese, të parashikuara në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji, nuk pezullon zbatimin e vendimit për masat shoqëruese.

3. Ankimi administrativ shqyrtohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative, i krijuar brenda strukturës përgjegjëse, i cili ka në përbërje nëpunës të pavarur nga ata të përfshirë në marrjen e vendimit të ankimuar.

4. Përbërja e Komisionit të Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative miratohet/përcaktohet me urdhër të ministrit.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative.

6. Kundër vendimit të dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative, operatori ekonomik mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

#### Neni 29

#### **Ekzekutimi i vendimit**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor.

2. Vendimi bëhet i ekzekutueshëm kur e drejta për ankim nuk është ushtruar brenda afateve kohore të parashikuara sipas këtij ligji ose në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni i Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative.

#### Neni 30

#### **Të ardhurat nga gjobat**

Të ardhurat, që burojnë nga vjelja e gjobave, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

#### KREU V

#### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 31

#### **Dispozitë kalimtare**

Deri në krijimin e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas nenit 9 të këtij ligji, ngarkohet Inspektorati Qendror Teknik për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

#### Neni 32

Kërkesat e këtij ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve kanë epërsi mbi çdo dispozitë të ligjeve apo akteve nënligjore të tjera që bien në kundërshtim me këtë ligj.

#### Neni 33

#### **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, shfuqizohet.





Neni 34  
**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 1, 9 pika 2, 12, 13 dhe 28 pika 5 të këtij ligji.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7170, datë 1.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 481, datë 17.11.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9662, DATË 18.2.2006 “PËR  
BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9662, datë 18.2.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 ndarja I bëhet ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Veprimtari bankare” është pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet.”.

2. Pas shkronjës “b” të pikës 5 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) një subjekt nuk do të quhet se ka pranuar depozita monetare nga publiku nëse pranimi i depozitës/depozitave është kryer menjëherë përkundrejt emetimit nga ky subjekt të parasë elektronike.”.

3. Pas pikës 45 të nënndarjes I shtohen pikat 46, 47, 48, 49, 50 e 51 me këtë përmbajtje:

“46. “Institucion i parasë elektronike” është subjekti financiar jobankë që kryen veprimtarinë financiare të emetimit të parasë elektronike, në bazë të licencës së miratuar, të mbështetur në këtë ligj për këtë qëllim, nga Banka e Shqipërisë.

47. “Para elektronike” është vlera monetare e regjistruar elektronikisht ose në mënyrë magnetike, e cila emetohet me pranimin e fondeve për qëllime të kryerjes së transaksioneve të

pagesës dhe që përfaqëson një detyrim të emetuesit të parasë elektronike ndaj pranuesit të saj, i cili është një person fizik ose juridik, i ndryshëm nga emetuesi i parasë elektronike.

48. “Shitje e bankës” është shitja e pjesshme ose e plotë e aktiveve ose aksioneve të saj.

49. “Bankë urë” është një bankë e përkohshme, e krijuar me vendim të Bankës së Shqipërisë, për të administruar depozitat dhe detyrimet e një banke që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose në likuidim të detyruar. Banka e Shqipërisë mund të krijojë bankën urë për një ose disa nga qëllimet e mëposhtme:

a) të marrë përsipër depozitat e një banke, që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose likuidim të detyruar;

b) të marrë përsipër detyrime të tjera, përfshirë marrëdhëniet e besimit të një banke, që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose në likuidim të detyruar, siç Banka e Shqipërisë mund ta çmojë të përshtatshme;

c) të blejë ose të marrë përsipër një ose të gjitha të drejtat apo aktivet e një banke, që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose në likuidim të detyruar, siç Banka e Shqipërisë mund ta çmojë të përshtatshme;

ç) të përmbushë funksione të tjera të përkohshme, siç Banka e Shqipërisë mund ta çmojë të përshtatshme, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatim të tij.

50. “Shoqëri mëmë” është personi juridik, i cili, në marrëdhënie me një person tjetër juridik, plotëson të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) zotëron shumicën e të drejtave të votës në këtë person;

b) ka të drejtën të emërojë dhe të shkarkojë shumicën e anëtarëve të drejtorisë ose të këshillit mbikëqyrës/drejtues ose të organeve të tjera drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të këtij personi dhe është, në të njëjtën kohë, anëtar ose aksionar i këtij personi;

c) ka të drejtën të ushtrojë një ndikimin dominues mbi këtë person, në sajë të një marrëveshjeje kontraktuale, të lidhur në bazë të legjislacionit tregtar ose për shkaqe të tjera ligjore;

ç) është anëtar ose aksionar i atij personi dhe ka shumicën e të drejtave të votës së tij, në sajë të një kontrate ose marrëveshjeje tjetër ligjore, të lidhur me anëtarët ose aksionarët e tjerë.

51. “Shumicë” është në çdo rast shumica e thjeshtë 50 për qind të votave plus 1 votë.”.

## Neni 2

Në nenin 7, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Bankat dhe degët e bankave të huaja, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, përdorin në gjuhën shqipe fjalën “bankë” në emrin e tyre tregtar.”.

## Neni 3

Në nenin 11, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Banka ka të drejtë të hapë degë, agjenci bankare, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të ofrojë shërbime ndërkufitare dhe të hapë zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet dhe kriteret e hapjes së një dege, agjencie bankare, zyre përfaqësimi ose ofrimit të shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkufitare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

## Neni 4

Në nenin 19 pika 2, shkronja “ç” shfuqizohet.



## Neni 5

Në nenin 24 pika 1, pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k” me këtë përmbajtje:

“k) të riorganizohet juridikisht nëpërmjet bashkimit, ndarjes ose çdo forme tjetër të ngjashme.”.

## Neni 6

Në nenin 26, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3) Banka ose dega e bankës së huaj njofton Bankën e Shqipërisë përpara se të ofrojë shërbime bankare dhe/ose financiare ndërkufitare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë ofrimin e këtyre shërbimeve ndërkufitare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga banka, në bazë të kriterëve të përcaktuara prej saj me akt nënligjor.”.

## Neni 7

Në kreun II, pas nenit 29 shtohen nenet 29/1, 29/2 dhe 29/3 me këtë përmbajtje:

### “Neni 29/1

#### **Mënyra e veçantë e krijimit të një banke vendase, nëpërmjet shndërrimit të degës së bankës së huaj, që ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë**

1. Banka e huaj, e cila ushtron veprimtari bankare në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet degës së saj, në bazë të licencës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë, mund të shndërrojë degën e saj në një filial, në formën e shoqërisë aksionare, nëpërmjet regjistrimit të kapitalit të dhuruar në aksione të nënshkruara nga banka e huaj.

2. Shndërrimi si më sipër i degës së bankës së huaj në filial/bankë vendase mund të ndodhë me kërkesë të vetë bankës së huaj ose kur gjykohet i nevojshëm nga Banka e Shqipërisë, për arsye të administrimit të riskut sistemik. Kur shndërrimi kërkohet nga banka e huaj, kërkesa duhet miratuar nga Banka e Shqipërisë, e cila mund të refuzojë të japë miratimin nëse gjykon se shndërrimi mund të dëmtojë ekonominë kombëtare apo interesat shtetërorë, ose nëse çmon se nga shndërrimi mund të përkeqësohet gjendja financiare apo respektimi i normave mbikëqyrëse.

3. Shndërrimi si më sipër i degës së huaj në filial/bankë vendase është i detyrueshëm kur gjykohet i nevojshëm me vendim të Bankës së Shqipërisë, për arsye të administrimit të riskut sistemik.

4. Në rastin e shndërrimit të degës së bankës së huaj në filial të bankës së huaj, kapitali i filialit do të konsiderohet se është shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit, të certifikuara nga eksperti i kontabël:

- a) kapital i dhuruar i paguar;
- b) rezervat;
- c) diferenca rivlerësimi;
- ç) fitimet e pashpërndara;
- d) fitim-humbja e vitit ushtrimor.

5. Në rastin e shndërrimit, kapitali rregullator i bankës ose pjesë të tij nuk duhet të bien nën nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për licencimin e një banke.

6. Procesi i shndërrimit të degës së bankës së huaj në filial/bankë realizohet brenda 3 muajve nga miratimi i kërkesës së bankës së huaj nga Banka e Shqipërisë dhe brenda 6 muajve kur shndërrimi është kërkuar me vendim të Bankës së Shqipërisë. Ky afat mund të zgjatet me vendim të

Bankës së Shqipërisë. Në rast të refuzimit të shndërrimit ose të mosrespektimit të afatit për realizimin e procesit të shndërrimit, Banka e Shqipërisë mund të marrë masat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë ligj, si dhe mund të revokojë licencën e degës së bankës së huaj dhe ta vendosë atë në likuidim të detyruar.

7. Procesi i shndërrimit të degës së bankës së huaj në bankë / filial me kërkesë të vetë bankës hyn në fuqi me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të procesverbalit / vendimit për shndërrim të asamblesë së përgjithshme ose organit tjetër përgjegjës të bankës mëmë, se bashku me vendimin e Bankës së Shqipërisë për miratimin e shndërrimit.

8. Procesi i shndërrimit të degës së bankës së huaj në bankë/filial me vendim të Bankës së Shqipërisë hyn në fuqi me njoftimin e këtij vendimi përfaqësuesve ligjorë të degës së bankës së huaj dhe/ose bankës mëmë ose në datën e përcaktuar nga kjo e fundit në vendimin për shndërrim. Ky vendim njoftohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mund të publikohet pas realizimit të procesit të shndërrimit.

9. Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që:

a) banka mëmë e degës së bankës së huaj, që shndërrohet, të marrë pjesë në kapitalin aksionar të filialit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;

b) të drejtat e bankës mëmë dhe të personave të tretë ndaj degës së bankës së huaj, që shndërrohet, të vazhdojnë të zbatohen edhe për filialin.

#### Neni 29/2

#### **Procedura e shndërrimit**

1. Drejtorja e degës së bankës së huaj, që shndërrohet, paraqet në Bankën e Shqipërisë një raport të hollësishëm, ku shpjegohen bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar dhe/ose arsyet përkatëse. Raporti përmban dhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit të shndërrimit, të cilat janë hasur, si dhe duhet të përshkruajë edhe efektin që parashikohet të ketë shndërrimi te normat rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe te punëmarrësit e degës së bankës së huaj.

2. Vendimi për shndërrimin e degës së bankës së huaj, kur shndërrimi kërkohet nga banka e huaj, duhet të merret nga asambleja e përgjithshme ose organi tjetër kompetent i bankës mëmë. Nëse shndërrimi ka si pasojë ndryshimin e të drejtave dhe të detyrimeve të veçanta të aksionarëve, atëherë vlefshmëria e vendimit për shndërrim i nënshtrohet miratimit të aksionarëve të prekur, sipas kërkesave të legjislacionit tregtar përkatës.

3. Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, zbatohen përkatësisht nenet 221, 222 e 223 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

4. Për përgjegjësitë ligjore të anëtarëve të drejtorisë dhe administratorëve të tjerë të degës së bankës së huaj në shndërrim, për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre, gjatë kryerjes së shndërrimit, zbatohen, përkatësisht, dispozitat e nenit 224 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### Neni 29/3

#### **Efektet juridike të shndërrimit**

1. Shndërrimi nuk sjell pasojë mbi të drejtat e detyrimet, që dega e bankës së huaj ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Filiali i bankës së huaj trashëgon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga operacionet dhe veprimtaria/veprimtaritë e degës së bankës së huaj, që i nënshtrohet shndërrimit, përfshirë totalin e depozitave të grumbulluara. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e degës së bankës së huaj, që i nënshtrohet shndërrimit, në raport me palë të treta, para hyrjes në fuqi të



procesit të shndërrimit, vazhdojnë të mbeten në fuqi për filialin pas shndërrimit, sipas përcaktimeve në aktet apo marrëveshjet përkatëse me këto palë.

2. Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, kur shndërrimi ndodh sepse gjykohet i nevojshëm nga Banka e Shqipërisë, kryhet pa qenë e nevojshme të merret pëlqimi paraprak i depozituesve, kreditorëve të tjerë, aksionarë me të drejta të veçanta ose palëve të tjera, të treta.

3. Me hyrjen në fuqi të procesit të shndërrimit, të gjitha aktivet financiare dhe fizike, në pronësinë ose administrimin e degës së bankës së huaj, që i nënshtrohet shndërrimit, vazhdojnë të mbeten në pronësi ose administrim të filialit

4. Për efekt të regjistrimit tatimor, filiali vazhdon të mbajë numrin e NIPT-it, që ka në përdorim dega e bankës së huaj që i nënshtrohet shndërrimit.

5. Filiali i krijuar si rrjedhojë e shndërrimit të degës së bankës së huaj nuk i nënshtrohet një procedure të re licencimi nga Banka e Shqipërisë, por kjo e fundit verifikon kushtet ligjore dhe nënligjore, duke miratuar ose refuzuar shndërrimin e degës së bankës së huaj në filial. Në rast se Banka e Shqipërisë miraton shndërrimin, filiali trashëgon licencën e degës së bankës së huaj të shndërruar. Në këtë rast Banka e Shqipërisë pajis filialin/bankën me formatin e ri të licencës që reflekton ndryshimin e emërimit nga degë e bankës së huaj në bankë.

6. Depozitat e grumbulluara nga dega e bankës së huaj të shndërruar në bankë/filial mbeten të siguruara, sipas përcaktimeve të ligjit “Për sigurimin e depozitave”. Me këtë shndërrim filiali/banka është pjesë e skemës së sigurimit të depozitave, sipas përcaktimeve të ligjit “Për sigurimin e depozitave”, duke vazhduar të gjitha marrëdhëniet që ka pasur dega e bankës së huaj.

7. Pas realizimit të procesit të shndërrimit, filiali regjistrohet në regjistrin tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ndërkohë që dega e bankës së huaj çregjistrohet nga ky regjistër.

8. Filiali i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij. Filiali respekton të gjitha normat dhe kërkesat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, të miratuara në bazë të këtij ligji.”.

#### Neni 8

Në nenin 35 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Anëtarët e këshillit drejtues emërohen nga asambleja e aksionarëve për një periudhë 4-vjeçare dhe kanë të drejtë të rizgjidhen për të njëjtin mandat, pa kufizim. Anëtarët e parë të këshillit drejtues caktohen në statut”.

2. Në pikën 4 fjalët “të paktën një e treta” zëvendësohen me fjalën “ shumica”.

#### Neni 9

Në nenin 41, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) është aksionar i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i më shumë se 5 për qind të aksioneve me të drejtë vote të një banke tjetër ose personi të lidhur me të.”.

#### Neni 10

Në nenin 54 pika 2 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “ç” fjalët “duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare dhe kartat e pagesës” shfuqizohen.

2. Pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike.”.

#### Neni 11

Në nenin 58, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) tipologjinë e rreziqeve, si dhe parimet, metodat dhe rregullat për vlerësimin dhe administrimin e tyre.”.

#### Neni 12

Ne neni 64 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “me të” zëvendësohen me fjalët “ndërmjet tyre”.

2. Në pikën 2 fjala “shoqëria” zëvendësohet me fjalën “banka”.

3. Në pikën 3, pas fjalëve “të lidhur me” fjala “të” zëvendësohet me fjalën “bankën”.

#### Neni 13

Pas nenit 66 shtohet neni 66/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 66/1

#### **Rreziku sistemik**

Rreziku sistemik është rreziku që kërcënon qëndrueshmërinë, vlerën e aktiveve dhe/ose besimin në sistemin ose tregun bankar dhe financiar në tërësi dhe që mund të shkaktohet nga ngjarje apo faktorë të veçantë në një ose disa pjesëmarrës të këtij sistemi. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor mënyrat dhe rregullat për parandalimin dhe/ose administrimin e këtij rreziku.”.

#### Neni 14

Në nenin 74 pika 2, pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“e) urdhëron aksionarët për shitjen e disa ose të gjitha aktiveve të bankës dhe transferimin e një pjese ose të të gjitha detyrimeve të bankës, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, te një bankë ose një subjekt tjetër që miratohet nga Banka e Shqipërisë;

“ë) urdhëron aksionarët të kryejnë riorganizimin juridik të bankës ose shitjen e saj te një bankë tjetër që miratohet nga Banka e Shqipërisë;

“f) krijon bankën urë.”.

#### Neni 15

Në nenin 81, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) krijimin e grupit mbikëqyrës, i cili vlerëson mundësinë e krijimit të bankës urë dhe/ose përgatitjen e bankës për kalimin në fazën e kujdestarisë ose likuidimit. Krijimi, funksionimi dhe detyrat e grupit mbikëqyrës përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.”.



## Neni 16

Pas nenit 81 shtohen nenet 81/1, 81/2, 81/3 dhe 81/4 me këtë përmbajtje:

### “Neni 81/1

#### **Krijimi dhe funksionimi i bankës urë**

1. Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë me akt nënligjor kushtet e krijimit, licencimit dhe funksionimit të bankës urë.

2. Nëse do të jetë e nevojshme, fondet për kapitalizimin e bankës urë ose fondet operative në vend të kapitalit për funksionimin e saj, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Me vendimin për krijimin e bankës urë, Banka e Shqipërisë përcakton dhe të drejtat apo aktivet që do të marrë përsipër apo do të blejë banka urë, si dhe detyrimet që do t'i transferohen asaj nga banka që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose likuidim të detyruar. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për krijimin e bankës urë mund të përcaktojë dhe funksione të tjera të përkohshme që duhet të përmbushë kjo e fundit, sipas gjykimit të Bankës së Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë, me vendime të mëvonshme, pas vendimit për krijimin e bankës urë, mund të përcaktojë të drejta apo aktive të tjera që do të marrë përsipër apo do të blejë banka urë, si dhe detyrime të tjera që do t'i transferohen asaj nga banka, të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin për krijimin e bankës urë.

5. Me licencimin e saj nga Banka e Shqipërisë, bankës urë i transferohen operacionet e bankës, që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose likuidim të detyruar, si dhe përmbush funksionet për të cilat është krijuar, në përputhje me pikën 47 të nenit 4 të këtij ligji, dhe vendimit të Bankës së Shqipërisë për krijimin dhe licencimin e saj.

6. Depozitat që mund t'i transferohen bankës urë nga banka, që mund të vendoset ose është vendosur në kujdestari ose likuidim të detyruar, sipas vendimit të Bankës së Shqipërisë për krijimin e bankës urë, mbeten të siguruara, sipas përcaktimeve të ligjit për sigurimin e depozitave. Me krijimin dhe licencimin e saj, banka urë është pjesë e skemës së sigurimit të depozitave, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave.

7. Në rast se në bazë të vendimit për krijimin e bankës urë, kësaj i transferohen pjesërisht të drejtat apo aktivet e një banke të vendosur në likuidim të detyruar, pjesa e mbetur e aseteve i nënshtrohet likuidimit.

### Neni 81/2

#### **Organizimi dhe drejtimi i bankës urë**

1. Statuti i bankës urë miratohet nga Banka e Shqipërisë dhe regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2. Banka e Shqipërisë miraton dhe mund të shkarkojë në çdo kohë administratorët e bankës urë.

3. Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë masën e shpërblimit dhe kompensime të tjera të mundshme për administratorët e bankës urë.

4. Çdo dispozitë e legjislacionit tregtar dhe legjislacionit tjetër në fuqi, që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për krijimin, licencimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimin e bankës urë, nuk gjen zbatim për këto të fundit.

Neni 81/3

**Mënyra e kryerjes së veprimtarisë**

1. Banka urë ushtron veprimtaritë dhe përmbush funksionet e parashikuara në vendimin për krijimin e saj, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, akteve nënligjore përkatëse, si dhe licencës dhe statutit të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka urë mund të investojë mjetet e saj në mënyrat dhe sipas kritereve të përcaktuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

3. Përveç sa parashikohet në nenin 24 të këtij ligji, banka urë nuk mund të disponojë mbi të drejtat, detyrimet, aksionet e saj ose të marrë pjesë në transaksione të tjera të ngjashme, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

4. Banka urë është e përjashtuar nga të gjitha tatimet dhe taksat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 81/4

**Mbyllja dhe/ose likuidimi i bankës urë**

Nëse kapitali i bankës urë dhe aktivet/të drejtat dhe detyrimet e saj nuk i janë shitur ose transferuar një banke tjetër vendase ose të huaj, brenda dy viteve nga data e krijimit të saj ose brenda afatit të parashikuar në vendimin për krijimin e bankës urë nga Banka e Shqipërisë, kjo e fundit mund të vendosë mbarimin e operacioneve të saj dhe kalimin e bankës urë në likuidim. Procedura dhe mënyra e likuidimit të bankës urë përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.”.

Neni 17

Në nenin 89 pika 1 shkronja “a”, si dhe në pikat 2 dhe 3, pas fjalëve “Administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj” shtohen fjalët “dhe bankën dhe/ose degën e bankës së huaj”.

Neni 18

Në nenin 91 pika 2, përpara fjalëve “autoriteteve juridike që e fitojnë këtë të drejtë me ligj” shtohen fjalët “kujdestarit dhe likuidatorit të emëruar nga Banka e Shqipërisë”.

Neni 19

Në nenin 96 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2 shkronja “c”, para fjalëve “dhe detyrat kryesore të tij” shtohen fjalët “emri i kujdestarit”.

2. Në pikën 3, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni botohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare.”.

Neni 20

Në nenin 101 bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 6, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) kujdestari, me miratimin e grupit mbikëqyrës, mund të vendosë që banka të mos mbledhë depozita dhe të mos paguajë detyrimet që banka ka ndaj palëve të treta, për një periudhë të përkohshme kohe.”.





2. Në pikën 7 shkronja “a”, nënndarja “iii” ndryshohet si më poshtë:

“iii) evidenton pjesën e aktiveve të këqija, duke cilësuar brenda tyre kreditë me probleme, dhe ushtron të drejtat ligjore në lidhje me fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për këto kredi dhe masa të tjera ligjore për ekzekutimin e detyrimeve;”.

#### Neni 21

Në nenin 116, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Banka e Shqipërisë udhëzon likuidatorin e emëruar për kryerjen e procedurës së likuidimit të detyruar të bankës, sipas akteve nënligjore të miratuara prej saj.”.

#### Neni 22

Në nenin 119 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) të likuidojë aktivet e bankës, siç parashikohet në këtë kre, me kusht që Banka e Shqipërisë të miratojë ose të refuzojë këtë likuidim.”.

2. Në pikën 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) të negociojë për shitjen në mënyrë kolektive të disa ose të gjitha aktiveve të bankës së vendosur në likuidim të detyruar dhe transferimin e një pjese ose të të gjitha detyrimeve të saj, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, te një bankë tjetër e miratuar nga Banka e Shqipërisë. Për shitjen e disa ose të gjitha aktiveve të bankës së vendosur në likuidim të detyruar dhe transferimin e një pjese ose të të gjitha detyrimeve të saj, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, te një bankë tjetër, sipas kësaj pike, nuk është e nevojshme të merret miratimi i aksionarëve, depozituesve, kreditorëve ose palëve të treta. Shitja e disa ose të gjitha aktiveve të bankës së vendosur në likuidim të detyruar dhe transferimi i një pjese ose të gjitha detyrimeve të bankës, sipas kësaj pike, kryhen në bazë të parimit të trajtimit të barabartë të kreditorëve. Banka e Shqipërisë miraton transaksionin për shitjen në mënyrë kolektive të disa ose të gjitha aktiveve të bankës së vendosur në likuidim të detyruar dhe transferimin e një pjese ose të të gjitha detyrimeve të saj, përfshirë në çdo rast totalin e depozitave të siguruara, si dhe përcakton me akt nënligjor kushtet dhe procedurën e përzgjedhjes së bankës blerëse.”.

#### Neni 23

Në nenin 124 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Banka njofton zyrtarisht çdo klient të saj, para aplikimit të tyre, në rastin kur përbindjet e interesave janë të ndryshueshme. Njoftimi bëhet dhe nëpërmjet organeve të mjeteve të komunikimit masiv.”.

2. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë me akt nënligjor kërkesa dhe kritere të tjera të mbrojtjes së klientit, gjatë përfitimit nga ana e tij të veprimtarive bankare dhe financiare të parashikuara në këtë ligj.”.

#### Neni 24

Në nenin 127, pikat 1 dhe 8 ndryshohen si më poshtë:

“1. Banka e Shqipërisë mban Regjistrin e Kredive, i cili përmban informacion në lidhje me kreditë që bankat dhe degët e bankave të huaja u japin klientëve të tyre, si dhe rrezikun e kredisë në sistem.

8. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, mund të detyrojë dhe subjekte të tjera të mbikëqyrura prej saj të raportojnë për qëllim të Regjistrit të Kredive, në përputhje me dispozitat e këtij neni. Në Regjistrin e Kredive raportojnë dhe subjekte të tjera financiare që nuk mbikëqyren prej Bankës së Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet kësaj të fundit dhe këtyre subjekteve dhe/ose autoriteteve të tyre rregullatore. Koha dhe procedurat e raportimit të këtyre subjekteve përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.”.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7171, datë 1.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**

**Nr.10 482, datë 17.11.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9317, DATË 18.11.2004 “KODI HEKURUDHOR I  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Pika 1 e nenit 6 të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaritë në transportin hekurudhor, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VII. 6 të ligjit “Për licencat”. Këto veprimtari licencohen sipas dispozitave në vijim të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7172, datë 1.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**LIGJ**  
**Nr.10 483, datë 17.11.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9251, DATË 8.7.2004 “KODI DETAR I  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 9, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaritë detare, të përcaktuara në shkronjën "a" të nenit 8 të këtij ligji, përfshihen në kategorinë VII.4 të ligjit për licencat, ndërsa veprimtaritë e përcaktuara në shkronjat “b”, “ë”, “f” dhe “g” përfshihen në kategorinë VII.5 të ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas dispozitave në vijim, të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë””.

**Neni 2**

Në nenin 22, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Mjetet lundruese me flamur shqiptar, si edhe ato me flamur të një shteti të Bashkimit Europian mund të kenë pikënisje dhe destinacion të brendshëm në çdo port shqiptar e të huaj, kur plotësojnë kërkesat ligjore.

2. Mjetet lundruese me flamur të huaj, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 1 të këtij neni, lundrojnë vetëm ndërmjet një porti shqiptar dhe atij të huaj.”.

**Neni 3**

Në nenin 136, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kapiteni i anijes shqiptare duhet të jetë me shtetësi apo kombësi shqiptare ose shtetas i një shteti të Bashkimit Europian.”.

**Neni 4**

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7173, datë 1.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.141, datë 17.11.2011**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN  
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore (në vijim Komisioni).
- II. Komisioni ka për detyrë hartimin e amendamenteve për kuadrin ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODHIR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009 dhe ato vendore të vitit 2011.
- III. Anëtarësia e Komisionit formohet me pjesëmarrjen e partive parlamentare, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe pakicës, sipas përbërjes së përcaktuar në këtë vendim.
- IV. Komisioni do të zhvillojë konsultime dhe seanca diskutimi me partitë politike joparlamentare të interesuara për reformën zgjedhore, të cilat në zgjedhjet e fundit kanë marrë më shumë se 1 për qind të votave në shkallë vendi, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në procesin zgjedhor. Konsultime e dëgjesa publike do të zhvillohen me kërkesën e palëve dhe me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe me institucione shtetërore që kanë rol në procesin zgjedhor.
- V. Komisioni drejtohet nga dy bashkëkryetarë një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.
- VI. Pranë Komisionit ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
- VII. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, OSBE/ODHIR-i dhe Komisioni i Venecias ftohen të ndjekin dhe të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.
- VIII. Çdo parti parlamentare ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Shumica parlamentare mirëpret propozimet e pakicës parlamentare, të bazuara në rekomandimet e OSBE/ODHIR-it dhe palët angazhohen të gjejnë konsensusin në lidhje me to. Për çështje të veçanta, për të cilat palët nuk kanë gjetur konsensus, konsensusi do të kërkohet me asistencën e ekspertizës së OSBE/ODHIR-it dhe Komisionit të Venecias.
- IX. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimmarrja e Komisionit do të synojë konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve dhe vetëm kur kanë marrë konsensusin e Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste.
- X. Komisioni përbëhet nga 10 anëtarë (5 anëtarë nga shumica parlamentare dhe 5 anëtarë nga pakica parlamentare). Anëtarët që i përkasin shumicës parlamentare caktohen 2 nga PD, 1 nga LSI, 1 nga PR dhe 1 nga PDIU. Anëtarët që i përkasin pakicës parlamentare caktohen 4 nga PS dhe 1 nga PBDNJ.



Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

1. Ilir Rusmali - bashkëkryetar (PD)
2. Damian Gjikhuri - bashkëkryetar (PS)
3. Viktor Gumi - anëtar (PD)
4. Vangjel Tavo - anëtar (LSI)
5. Fatmir Mediu - anëtar (PR)
6. Shpëtim Idrizi - anëtar (PDIU)
7. Vasilika Hysi - anëtare (PS)
8. Arben Isaraj - anëtar (PS)
9. Armando Subashi - anëtar (PS)
10. Vangjel Dule - anëtar (PBDNJ)

XI. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat tremujor nga data e mbledhjes së parë të tij. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.

XII. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.142, datë 17.11.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 161 pika 2 të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 44 pika 2, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe bazuar në dekretin nr.7149, datë 9.11.2011 të Presidentit të Republikës “Për propozimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Ardian Fullani zgjidhet Guvernator i Bankës së Shqipërisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.772, datë 10.11.2011**

**PËR LEJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, SI  
AUTORITET KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT  
DHE LIDHJEN E KONTRATAVE PËR OBJEKTETE E PARASHIKUARA PËR T'U  
REALIZUAR ME FONDET BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave, brenda datës 10.12.2011, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2011, për objektin e mëposhtëm të prokurimit:

“Ndërtimi i infrastrukturës (Public Key Infrastructure), PKI, dhe kuotimi i mirëmbajtjes së sistemit për një periudhë prej 4 (katër) vjetësh, e aplikueshme pas përfundimit të garancisë 1 (një) vit”, me fond limit 86 000 000 (tetëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, pa TVSH.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.782, datë 10.11.2011**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR, PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE  
FESTIVE PËR “VITIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Komisionit Shtetëror, për organizimin e veprimtarive festive për “Vitin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

2. Ky komision të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- a) Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme;
- b) Ministrin e Financave;
- c) Ministrin e Mbrojtjes;
- ç) Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- d) Ministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;



- dh) Ministrin e Brendshëm;
- e) Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- ë) Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit;
- f) Kryetarin e Akademisë së Shkencave;
- g) Drejtorin e Përgjithshëm të Arkivave të Shtetit;
- gj) Drejtorin e Bibliotekës Kombëtare;
- h) Drejtorin e Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Me ftesë të kryetarit në këtë grup ftohen të marrin pjesë edhe:

- Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës;
- Zëvendëskryeministri shqiptar i Republikës së Maqedonisë;
- Një përfaqësues i shoqatës kulturore “Vatra”;
- Një përfaqësues i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan (NAAC);
- Një përfaqësues i shqiptarëve të Malit të Zi dhe arbëreshëve të Italisë.

3. Komisioni të marrë të gjitha masat për hartimin e planit të veprimit dhe kalendarin e festimeve, si dhe të përcaktojë llojet e veprimtarive festive, në kuadër të vitit jubilar “Viti i 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

4. Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të krijojnë nënkomisionet e veçanta, sipas fushave, për organizimin e veprimtarive gjatë gjithë vitit jubilar.

5. Komisioni mbledhet me kërkesë të kryetarit dhe sa herë që shihet e nevojshme.

6. Ngarkohen të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të komisionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.784, datë 10.11.2011**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT  
RRUGOR, URA E BUJANIT-SOPOT, TROPOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Ura e Bujanit-Sopot, Tropojë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për arë, me sipërfaqe 4679 (katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m<sup>2</sup>, me vlerë të përgjithshme prej 1 100 205 (një milion e njëqind mijë e dyqind e pesë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 100 205 (një milion e njëqind mijë e dyqind e pesë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2011, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Shpronësimi të fillojë më 20.10.2011 dhe të përfundojë më 20.12.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi përkatës “Konfirmohet nga ZRPP-ja” në bazë të pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tropojë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tropojë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tropojë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE**  
**DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE**

**LISTA E NUMRIT TË PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR**  
**“SOPOT-URA E BUJANIT”**

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr.pas	Sip.që preket	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlefata Lekë	Lloji i pasurisë	Gjendja
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Selim	Mal	Çelaj	3490	72/1	410	214	87740	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
2	Brahim	Jakup	Hoxha	3490	72/2	83	214	17762	arë	Konfirmohet nga ZRPP-ja
3	Lulzim	Qazim	Çelaj	3490	72/4	170	214	36380	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
4	Hajredin	Qazim	Çelaj	3490	622/11	308	214	65912	arë	Konfirmohet nga ZRPP-ja
5	Mus	Tahir	Aliaj	3490	607/1/3	97	214	20758	arë	Konfirmohet nga ZRPP-ja
6	Rexhep	Arif	Rexha	3490	607/1/4	446	214	95444	arë	Konfirmohet nga ZRPP-ja
7	Mus	Zymer	Gosturani	1133	1007/4	386	260	100360	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
8	Fatmir	Zymer	Gosturani	1133	1007/3	641	260	166660	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
9	Riza	Zymer	Gosturani	1133	1007/1	392	260	101920	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
10	Idriz	Fazli	Gosturani	1133	1007/2	671	260	174460	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
11	Skënder	Ram	Byberi	2878	1009/1	1093	213	232809	pemëtore	Konfirmohet nga ZRPP-ja
	<b>SHUMA</b>					<b>4697</b>		<b>1100205</b>		





**VENDIM**  
**Nr.789, datë 16.11.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.769, DATË 15.7.2009 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E  
SHOQËRISË CIVILE (AMSHC)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të statutit, miratuar me vendimin nr.769, datë 15.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**


Në pikën 2 të nenit 18 të statutit të AMSHC-së, miratuar me vendimin nr.769, datë 15.7.2009 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:

“Struktura dhe organika e punonjësve të administratës së AMSHC-së është sipas lidhjeve nr.1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**STRUKTURA E ADMINISTRATËS SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
NR.474, DATË 16.6.2011**



ORGANIKA E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I <b>Drejtor ekzekutiv</b>		1
Sekretar		1
II <b>Spektori i administrimit të programeve të grandeve dhe zhvillimit rajonal</b>		(3)
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	2
III <b>Spektori i zhvillimit të programeve, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe komunikimit</b>		(4)
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	3
IV <b>Spektori i financës dhe kontrolli i brendshëm</b>		(4)
Përgjegjës sektori		1
Inspektor	III-a/1	1
Specialist	III-b	1
Magaznier	IV-a	1
<b>Punonjës gjithsej</b>		<b>13</b>

**VENDIM**

**Nr.791, datë 16.11.2011**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT, PËR PËRJASHTIMIN E KËRKESAVE PËR VIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Brazilit, për përjashtimin e kërkesave për vizë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT MBI PËRJASHTIMIN E**  
**KËRKESAVE PËR VIZË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federative e Brazilit (referuar më poshtë si “Palët”);

*duke u nisur* nga dëshira për forcimin e lidhjeve të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve;

*duke pranuar* nevojën e ruajtjes së parimit të reciprocitetit dhe për të lehtësuar udhëtimin në territoret e njëri-tjetrit të shtetasve të të dyja vendeve;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Shtetasit e secilës palë, mbajtës të një pasaporte kombëtare të vlefshme, do të përjashtohen nga kërkesat për vizë për të hyrë, dalë, kaluar transit dhe për të qëndruar në territorin shtetëror të secilës palë për qëllime turizmi dhe biznesi për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë, për çdo njëqind e tetëdhjetë ditë (180) të llogaritura nga hyrja e parë.

2. Qëllimet për biznes të përmendura në këtë nen do të kuptojnë pjesëmarrjen në takime biznesi, bisedimet për nënshkrimin e kontratave, diskutimin e projekteve dhe aktiviteteve të tjera që nuk përbëjnë punë të paguar apo punësim në territorin e palës tjetër.

3. Shtetasit e secilës palë, mbajtës të një pasaporte kombëtare të vlefshme duhet të marrin vizat e nevojshme sipas legjislacionit të palës tjetër nëse parashikojnë të qëndrojnë në territorin e palës tjetër për një periudhë më shumë se nëntëdhjetë ditë (90), ose për t’u punësuar apo të kryejnë punë me pagesë në territorin e palës tjetër,

Neni 2

Shtetasit e përmendur në këtë marrëveshje mund të hyjnë, të kalojnë transit dhe të largohen nga territori i palës tjetër në të gjitha pikat e kalimit kufitar të hapura për qarkullimin ndërkombëtar të udhëtarëve.

Neni 3

1. Gjatë qëndrimit të tyre, shtetasit e secilës palë do të respektojnë ligjet dhe rregullat që janë në fuqi në territorin e palës tjetër.

2. Palët do të njoftojnë reciprokisht njëra-tjetrën, sa më shpejt që të jetë e mundur, nëpërmjet kanaleve diplomatike për çdo ndryshim në legjislacionin dhe rregullat përkatëse që kanë të bëjnë me hyrjen, transitin, qëndrimin dhe largimin e të huajve.

Neni 4

Palët do t’i ripranojnë shtetasit në territoret e shteteve të tyre përkatëse pa ndonjë formalitet apo pagesë shtesë.

Neni 5

Kjo marrëveshje nuk i heq të drejtën asnjë pale për të refuzuar hyrjen apo të shkurtojë qëndrimin e shtetasve të palës tjetër të konsideruar të padëshirueshme.

#### Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, specimenet e pasaportave të tyre të vlefshme që përmenden në këtë marrëveshje, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje,

2. Në rast të futjes në përdorim të pasaportave të reja ose modifikimin e atyre ekzistuese, palët do t'i dërgojnë njëra-tjetrës, nëpërmjet kanaleve diplomatike, specimenet e këtyre pasaportave, të shoqëruara me informacion të hollësishëm në lidhje me karakteristikat dhe përdorimin e tyre jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para aplikimit të tyre.

#### Neni 7

1. Për arsye të sigurisë, të rregullit publik apo shëndetit publik, secila nga palët mund ta pezullojnë tërësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Pezullimi i marrëveshjes dhe anulimi i saj do t'i njoftohen palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike në afatin më të shpejtë të mundshëm.

#### Neni 8

1. Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë (tridhjetë) ditë nga data e notës së dytë diplomatike me anën e secilës, palët informojnë njëra-tjetrën se janë plotësuar kriteret ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin reciprok të palëve i shprehur zyrtarisht nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Secila nga palët, në rrugë diplomatike, mund ta denoncojë këtë marrëveshje në çdo kohë. Denoncimi i marrëveshjes do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë nga data e njoftimit.

Bërë në Brazilia, datë 27 tetor 2011, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, portugalisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha njësoj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, do të mbizotërojë versionin anglisht.

### VENDIM

Nr.792, datë 16.11.2011

### **PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PREZË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Prezë të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



Lista me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 317 (treqind e shtatëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtmshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Prezë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Prezë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-12,12/1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
13-17	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
21-23	Varreza publike	Në pronësi
24-27	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në strehimin dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
29	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
30-34	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
61-128	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
147-237	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
313-317	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në furnizimin me ujë të pijshëm	Në pronësi

## VENDIM

**Nr.793, datë 16.11.2011**

### **PËR DHËNIE FONDI FINANCIAR SHITESË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E PALLATIT NR.10, LAGJJA NR.6, RRUGA "M. SHKODRANI", KORÇË, DJEGUR NGA ZJARRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës, në buxhetin e vitit 2011, t'i jepet fondi financiar shtesë 4 905 000 (katër milionë e nëntëqind e pesë mijë) lekë, për rikonstruksionin e pallatit nr.10, lagjja nr.6, rruga "M. Shkodrani", Korçë, djegur nga zjarri.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, bashkia Korçë, si dhe prefekti i qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.794, datë 16.11.2011**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, BRENDA PROGRAMEVE TË  
MIRATUARA PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, NË BUXHETIN E VITIT 2011, ZËRI  
“SHPENZIME KORRENTE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, në buxhetin e vitit 2011, zëri “Shpenzime korrente”, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit t’i pakësohet fondi 29 400 000 (njëzet e nëntë milionë e katërqind mijë) lekë, në shpenzimet e personelit, dhe t’i shtohet fondi 9 000 000 (nëntë milionë) lekë, në shpenzimet operative, nga të cilat 4 000 000 (katër milionë) lekë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

b) Programit të sistemit të burgjeve t’i shtohet fondi 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, në shpenzime personeli, dhe 29 100 000 (njëzet e nëntë milionë e njëqind mijë) lekë, në shpenzimet operative, nga të cilat 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

c) Programit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor t’i pakësohet fondi 3 800 000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë, për shpenzime personeli, dhe t’i shtohet fondi 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë, në shpenzimet operative, nga të cilat 4 000 000 (katër milionë) lekë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

ç) Programit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave t’i pakësohet fondi 19 100 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekë, për shpenzime personeli, dhe t’i shtohet fondi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, në shpenzimet operative, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

d) Programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurisë t’i pakësohet fondi 31 700 000 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind mijë) lekë, për shpenzime personeli, dhe t’i shtohet fondi 20 500 000 (njëzet milionë e pesëqind mijë) lekë, në shpenzimet operative, nga të cilat 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

dh) Programit të Shërbimit të Provës t’i pakësohet fondi 7 300 000 (shtatë milionë e treqind mijë) lekë, për shpenzime personeli.

e) Programit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve t’i pakësohet fondi 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë, për shpenzime personeli.



ë) Programit të Institutit të Mjekësisë Ligjore t'i shtohet fondi 4 400 000 (katër milionë e katërqind mijë) lekë, për shpenzime operative, të cilat do të përdoren për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

f) Programit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare t'i shtohet fondi 300 000 (treqind mijë) lekë, për shpenzime personeli, dhe 3 000 000 (tre milionë) lekë, për shpenzime operative.

g) Programit të Institutit të të Përndjekurve Politikë t'i shtohet fondi 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, në sigurime shoqërore, dhe t'i pakësohet fondi 400 000 (katërqind mijë) lekë, në shpenzime për paga.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.795, datë 16.11.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “GAVRAN” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Gavran”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve për rezultatin, teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Romela Energy”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Gavran”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.796, datë 16.11.2011**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV TIRANË – PODGORICË, QARKU TIRANË, BASHKIA KAMZË, KOMUNA BËRXULL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë – Podgoricë, qarku Tiranë, bashkia Kamzë, komuna Bërxull sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të “OST”, sh.a.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme të shpronësimit prej 373.65 (treqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 4 327 073 (katër milionë e treqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëdhjetë e tre) lekësh.
  4. Fondi prej 4 327 073 (katër milionë e treqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëdhjetë e tre) lekësh të përballohet nga fondet e “OST”, sh.a.
  5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit dhjetor 2011 dhe të përfundojë brenda muajit mars 2012.
  6. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.
  7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “OST”, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**





LISTA E PRONARËVE ME REFLEKTIMIN E NDRYSHIMEVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 400 KV TIRANË-  
PODGORICË, QARKU TIRANË

Rrethi: Tiranë  
Bashkia: Kamzë  
Komuna: Bërçull

Nr	Objekti	Shpronësimi definitiv										Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa e pronarit	Dokumentacioni
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. i kadastral	Nr. i pasurisë	Nr. i shtyllës	Sasia, shpronësim definitiv m <sup>2</sup>	Çmimi shitje ZRPP lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e kompensimit			
1	Irl 400	Artur	Ukshin	Prela	Shtëpi	2066	54/67	302-303	27.25	30800	839,300	839,300	Kamzë	Me certifikatë pronësie
2	Irl 400	Zef		Perpalaj	Shtëpi	2066	54/59	302-303	42.6	30800	1,312,080	1,312,080	Kamzë	Me certifikatë pronësie
3	Irl 400	Dashamir	Safat	Lama	Shtëpi	2372	241/14	311-312	48.1	30800	1,481,480	1,481,480	Kamzë	Me certifikatë pronësie
4	Irl 400	Myrteza		Lalo	Shtëpi	2066	54/72	301-302	19.5	30800	600,600	600,600	Kamzë	Me certifikatë pronësie
5	Irl 400	Manushaqe		Sufa	Arë	1514	318/21	315	42.4	461	19,546	19,546	Bërçull	Në procedurë
6	Irl 400	Ajet		Shkurti	Arë	1514	318/21	315	60.5	461	27,891	27,891	Bërçull	Në procedurë
7	Irl 400	Pretendim	pronësie		Arë	1514	318/21	315	21.8	461	10,050	10,050	Bërçull	Në procedurë
8	Irl 400	Trashëgimtarët	Sulejmani		Arë	2066	40/72	301	111.5	324	36,126	36,126	Kamzë	Me certifikatë pronësie
		<b>SHUMA</b>							<b>373.65 m<sup>2</sup></b>			<b>4,327,073</b>		

**VENDIM**  
**Nr.797, datë 16.11.2011**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.776, DATË 4.6.2008 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE, NË ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 6 të vendimit nr.776, datë 4.6.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 6.1, si më poshtë vijon:

“6.1. Në rast të mungesës së interesit për dhënien me koncesion të kësaj zone, objektet pronë shtetërore, që ndodhen të lira brenda kësaj sipërfaqeje, i nënshtrohen procedurës së privatizimit.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.800, datë 16.11.2011**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË**  
**E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË**  
**SHTETASIT PËRPARIM HOXHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Përparim Hoxha.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.801, datë 16.11.2011**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES DHE TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 26.6.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të institucioneve të saj të varësisë, si autoritete kontraktore, për të përfunduar, brenda datës 20 dhjetor 2011, procedurat e prokurimit për shërbime dhe punë civile, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2011, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen dhe lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet e saj të varësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LISTA E OBJEKTEVE TË MBUMK-SË DHE INSTITUCIONEVE TË SAJ TË VARËSISË, PËR TË CILAT KËRKOHET LEJIMI I PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fondi limit në lekë (me TVSH)	Objekti i prokurimit	Vlera për t'u financuar në vitin 2011 (në lekë)	Faza e procedurës
1	Bordi i kullimit Shkodër	52 708 000	Rehabilitimi i kanalit ujitës Shkodër, pjesa e I-rë	5 000 000	Vlerësim oferte
2	Bordi i kullimit Shkodër	45 535 000	Rehabilitimi i kanalit ujitës Shkodër, pjesa e II-rë	5 000 000	Vlerësim oferte
3	Bordi i kullimit Shkodër	673 000	Mbikëqyrja e punimeve për realizimin e objektit “Rehabilitimi i kanalit ujitës Shkodër, pjesa e I-rë	63 000	Vlerësim oferte
4	Bordi i kullimit Shkodër	601 000	Mbikëqyrja e punimeve për realizimin e objektit “Rehabilitimi i kanalit ujitës Shkodër, pjesa e II-të	65 000	Vlerësim oferte
5	Bordi i kullimit Mat	121 368 000	Rehabilitimi i kanalit ujitës Sete, Dibër	3 641 479	Vlerësim oferte
6	Bordi i kullimit Mat	1 416 000	Mbikëqyrja e punimeve për realizimin e objektit “Rehabilitimi i kanalit ujitës Sete, Dibër”	42 000	Vlerësim oferte
	Totali	222 301 000			

**VENDIM**  
**Nr.802, datë 16.11.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.148, DATË 11.2.2009 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN MARTANESH, TË QARKUT TË  
DIBRËS”, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.523, DATË 30.6.2010 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË  
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË  
PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS MARTANESH, TË QARKUT TË DIBRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e një ndryshimi në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Martanesh, të qarkut të Dibrës. Lista është me 14 (katërmbëdhjetë) fletë, fillon me numër prone 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) dhe përfundon me numër 507 (pesëqind e shtatë).

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme shtetërore, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Martanesh të qarkut të Dibrës. Lista është me 5 (pesë) fletë, fillon me numër prone 805 (tetëqind e pesë) dhe përfundon me numër 948 (nëntëqind e dyzet e tetë).

3. Miratimin e listës shtesë, në listën përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Martanesh, të qarkut të Dibrës. Lista është me 5 (pesë) fletë, fillon me numër rendor 1(një) dhe përfundon me numër 148 (njëqind e dyzet e tetë).

4. Listat me pakësimet dhe shtesat në listën e inventarit, lista shtesë e pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të komunës Martanesh, si dhe tabela me nr.1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Martanesh e qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1, 4-5, 7, 10, 13-15, 17-21, 28-30 32-33, 243-244, 249-259, 290-301 310, 314-317, 319-320, 328-333, 370-371, 373-375, 378. 381-386, 393, 405, 407, 508-512 515-521, 524-525, 528-534, 541-549, 553-573, 627-635, 640-644, 648-652, 654, 656-659 661-662, 665-666, 668-669, 672	Pyje, sipërfaqe me bimësi pyjore, inproduktive, kullota etj.	Pronësi

### UDHËZIM

Nr.4728, datë 7.11.2011

#### PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP TË ADMINISTRIMIT TË BASHKËPRONËSISË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 20 pika 3 të ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”,

#### UDHËZOJMË:

1. Miratimin e kontratës tip sipas formatit bashkëlidhur.
  2. Në kontratat individuale, palët mund të parashikojnë çdo përcaktim, i cili nuk përmbahet në kontratën tip, mjafton që mos të bjerë ndesh me standardet dhe përmbajtjen e Kodit Civil, ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, dhe kontratës tip të miratuar me këtë udhëzim.
  3. Ngarkohen asambltetë e bashkëpronareve, administratorët dhe kryetarët e bashkive/komunave, për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE  
TRANSPORTIT  
Sokol Olldashi

MINISTËR I DREJTËSISË  
Eduard Halimi

KONTRATË TIP  
PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË

E lidhur sot në \_\_\_\_\_ në datë \_\_\_\_\_, ndërmjet:

Asamblesë së bashkëpronarëve, e përfaqësuar nga kryesia e regjistruar në librin e administratorëve të njësisë vendore \_\_\_\_\_ më datë \_\_\_\_\_, dhe autorizuar me vendim të asamblesë nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, për nënshkrimin e kontratës për administrimin e bashkëpronësisë, miratuar në parim nga asambleja e bashkëpronarëve, me vendim nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, konkretisht nga:

znj/z. \_\_\_\_\_, person me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta / letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_,

znj/z. \_\_\_\_\_, person me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta /letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_,

znj/z. \_\_\_\_\_, person me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta /letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_,

të gjithë banues në adresën \_\_\_\_\_, që këtej e tutje do quhen shkurtimisht “Porositësi”;

ose

Kryetarit të bashkisë/komunës \_\_\_\_\_, përfaqësuar me prokurë nga \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, me nr. identiteti \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_, i cili vepron në emër të bashkëpronësisë me nr. pasurie \_\_\_\_\_, adresë \_\_\_\_\_, sipas kërkesës me shkrim dhe të noterizuar, të paraqitur nga:

znj./z. \_\_\_\_\_, me pasaportë/letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_

znj./z. \_\_\_\_\_, me pasaportë/letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_

znj./z. \_\_\_\_\_, me pasaportë/letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_

znj./z. \_\_\_\_\_, me pasaportë/letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_

të gjithë bashkëpronarë, që zotërojnë ..... % të bashkëpronësisë

dhe

- Administratorit, z. \_\_\_\_\_, person fizik, me nr. \_\_\_\_\_ NIPT-i, identifikuar nga pasaporta/ letërnjoftimi nr. \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_ /regjistruar me nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, në librin e administratorëve pranë bashkisë/komunës \_\_\_\_\_.

ose

- Shoqërisë administruese, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor znj/z. \_\_\_\_\_, identifikuar nga nr. NIPT-i \_\_\_\_\_, me seli dhe adresë në \_\_\_\_\_ regjistruar me nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, në librin e administratorëve pranë bashkisë/komunës \_\_\_\_\_.

që këtej e tutje do quhet shkurtimisht “Sipërmarrësi”

Baza ligjore: Neni 850 e vijues të ligjit nr.7850, date 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” dhe ligji nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

Neni 1

**Objekti i kontratës**

Porositësi dhe sipërmarrësi bien dakord që sipërmarrësi të administrojë pronën e përbashkët siç përshkruhet në vijim të kësaj kontrate me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë dhe të kontaktojë rregullisht me personin e autorizuar nga porositësi.



## Neni 2 Detyrimet e sipërmarrësit

### 1. Sipërmarrësi merr përsipër:

- a) të kontrollojë derdhjen, në numrin e llogarisë bankare, e tarifës së administrimit nga çdo bashkëpronar sipas kuotës së miratuar nga asambleja dhe brenda datës së përcaktuar dhe të informojë porositësin sa herë shkelet afati, mbi bashkëpronarët që nuk kanë kryer pagesën e tarifës;
- b) të informojë një herë në katër muaj dhe në fund të vitit, përpara mbledhjes vjetore të asamblesë së bashkëpronarëve mbi përdorimin e tarifës së administrimit, sipas planit dhe zërave të miratuar, si dhe për çdo shpenzim të kryer jashtë parashikimeve;
- c) të hartojë projekt-buxhetin për vitin e ardhshëm buxhetor dhe t'ia paraqesë atë porositësit, 15 ditë përpara mbledhjes vjetore të asamblesë;
- d) të mbajë e ruajë faturat e shpenzimeve të kryera dhe t'ia paraqesë porositësit së bashku me raportin financiar të fundvitit;
- e) të regjistrojë ashensorin pranë autoritetit të mbikëqyrjes së tregut dhe të mbikëqyrë mirëmbajtjen e ashensorit nga personi fizik/ a juridik i kontraktuar nga administratori/kryesia;
- f) të mbikëqyrë cilësinë dhe frekuencën e pastrimit sipas kontratës së lidhur mes porositësit dhe personit fizik a juridik dhe ta informojë atë sa herë vëren shkelje të kushteve të kontratës; ose
- g) të realizojë pastrimin sipas cilësisë, standardeve dhe frekuencës të specifikuara më poshtë:
  - i) fshirje dhe larje e dysHEMEVE të korridoreve me/pa solucion pastrimi, shesh pushimeve, hyrjes dhe shkallëve çdo \_\_\_\_ ditë;
  - ii) larje e xhamave të mjediseve të përbashkëta çdo \_\_\_\_\_ muaj;
  - iii) fshirje e pluhurave të parrmakëve të shkallëve, kutive postare, etj., çdo \_\_\_\_\_ muaj;
  - iv) tjetër \_\_\_\_\_.
- h) të mirëmbajë pompën e ujit dhe të sigurojë riparimin e shpejtë të defekteve;
- i) të furnizojë në kohë me lëndë të parë ngrohjen qendrore dhe të sigurojë mirëfunksionimin e sistemit;
- j) të mbikëqyrë sistemin mbrojtjes kundra zjarrit, të sigurojë mirëmbajtjen e tij dhe të riparojë dëmet që mund t'i jenë shkaktuar;
- k) të kontrollojë gjendjen e tarracës, të tubacioneve të shkarkimit të ujërave të shiut dhe të sigurojë pastrimin e piletave të shkarkimit;
- l) të kontrollojë gjendjen e ndriçimit të shkallëve, korridoreve e shesh pushimeve, të zëvendësojë poçet e djegur, ndriçuesit e thyer dhe çelësat e prishur;
- m) të kontrollojë mbi praninë e insekteve a kafshëve të dëmshme për shëndetin dhe që mund të përbëjnë risk për përhapjen e sëmundjeve, të higjienizojë mjediset e përbashkëta, kur vërehet prania e tyre, si dhe të verë në dijeni porositësin dhe të njoftojë inspektoratin shëndetësor, nëse edhe pas dezinfektimit vazhdon prezenca e tyre;
- n) të mos lejojë asnjë person të paautorizuar nga porositësi të ndërhyjë në depozitën e përbashkët të ujit;
- o) të mbikëqyrë respektimin e normave detyruese të përcaktuara në rregulloren e bashkëpronësisë, miratuar me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ të asamblesë së bashkëpronarëve;
- p) t'i drejtohet gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, sipas pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr.10 112/2009 si dhe të ndjekë deri në fund të ekzekutimit, për mospagesën e tarifës së administrimit nga ndonjëri prej bashkëpronarëve, kur një kërkesë e tillë i paraqitet me shkrim nga porositësi;

2. Sipërmarrësit i ndalohet të kontraktojë, paguajë apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me të tretë, nëse më parë nuk ka marrë autorizimin nga porositësi.

3. Për riparimin e defekteve, pagesa e të cilave nuk përfshihet në tarifën e administrimit, sipërmarrësi njofton menjëherë porositësin dhe kontraktin për shërbimin, vetëm pasi ka marrë miratim me shkrim nga porositësi për kryerjen e riparimit dhe shumën e pagesës.

4. Porositësi nuk mbart detyrime financiare kundrejt sipërmarrësit për punime të kryera a pajisje e mallra të blera, ose porositura nga sipërmarrësi, të cilat tejkalojnë tarifën mujore të administrimit dhe për të cilën nuk është marrë më parë miratimi me shkrim nga porositësi.

### Neni 3

#### Detyrimet e porositësit

1. Porositësi merr përsipër:

a) të paguajë në shumën prej \_\_\_\_\_ lekë brenda datës \_\_\_\_\_ të çdo muaji sipërmarrësin;

b) brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate:

i) të njoftojë adresën, numrin e telefonit, dhe kontakte të tjera të personit që do të mbajë kontakte me sipërmarrësin (kujdestari);

ii) emrin/emrat e personave të ngarkuar me mbikëqyrjen e punës së sipërmarrësit;

iii) listën emërore të bashkëpronarëve (përfaqësuesi i tij);

iv) llojin e aktivitetit që zhvillohet në secilën njësi individuale;

v) kuotat e pjesëmarrjes në bashkëpronësi të secilit bashkëpronar.

c) të bëjë me dije sipërmarrësin për çdo vendim që merr asambleja e bashkëpronarëve e cila ndikon në shërbimin që ofron sipërmarrësi;

### Neni 4

#### Paga dhe afati i pagesës

Porositësi do t'i paguajë sipërmarrësit shumën prej ..... për realizimin e punës. Pagesa do të jetë mujore dhe do të bëhet pranë bankës \_\_\_\_\_, me adresë: \_\_\_\_\_, numër llogarie: \_\_\_\_\_, në emër të "Asambleja e bashkëpronarëve të pallatit nr. \_\_\_\_\_, hyrja \_\_\_\_\_, lagja \_\_\_\_\_, qyteti/fshati".

Pagesa e parë do të bëhet më datën që i korrespondon 30 ditëve kalendrike nga data e fillimit të punës të sipërmarrësit.

### Neni 5

#### Garancia

Sipërmarrësi është dakord të ngurtësojë si garanci për porositësin shumën e barabartë me pagesën mujore prej \_\_\_\_\_ lekë, në bankën \_\_\_\_\_, me adresë: \_\_\_\_\_, numër llogarie: \_\_\_\_\_, në emër të \_\_\_\_\_.

Porositësi është dakord të ngurtësojë, si garanci për sipërmarrësin, shumën e barabartë me pagesën mujore prej \_\_\_\_\_ lekë, në bankën \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_, numër llogarie: \_\_\_\_\_, në emër të "Asambleja e bashkëpronarëve të pallatit nr. \_\_\_\_\_, hyrja \_\_\_\_\_, lagja \_\_\_\_\_, qyteti/fshati

Garancia parashikon zhdëmtimin e dëmeve që mund ti kenë shkaktuar palët njëra-tjetrës. Për të shfaqur një pretendim nën garancinë, pala e dëmtuar duhet të njoftojnë palën tjetër brenda një muaji nga pagesa e fundit.





## Neni 6 Forca madhore

1. Palët në këtë kontratë nuk mbajnë përgjegjësi për mospërbushjen e detyrimeve në kohë, kur ndodhen në kushtet e forcës madhore.

2. Në kushtet e forcës madhore, palët në këtë kontratë duhet të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën. Sipërmarrësi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës dhe të kërkojë të gjitha mjetet e nevojshme për zbatimin e detyrimeve, deri në masën që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## Neni 7 Kohëzgjatja e kontratës

1. Kontrata lidhet për një periudhë një vjeçare dhe, rinovohet automatikisht në heshtje për një periudhë tjetër një vjeçare, nëse asnjëra nga palët nuk njofton përfundimin e saj me anë të një shkrese të paktën tre muaj përpara përfundimit të afatit të kontratës.

2. Nëse midis palëve ka mosmarrëveshje dhe pala dëmtuese ka shkaktuar dëm material, pala e dëmtuar njofton me postë palën dëmtuese duke specifikuar në detaje shkeljet e kësaj kontrate. Në rast se pala dëmtuese, brenda 30-ditëve pas marrjes së njoftimit, nuk kthen përgjigje, atëherë pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, bazuar në aktet ligjore në fuqi.

3. Për pasojat juridike, që lindin në të gjitha rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës qoftë nga njëra apo dhe nga tjetra palë, do të zbatohen dispozitat e nenit 868 e në vijim, të Kodit Civil, për kontratën e sipërmarrjes.

## Neni 8 Komunikimi

Gjithë komunikimet në lidhje me këtë marrëveshje duhet të jenë me shkrim dhe duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Sipërmarrësi – personi i kontaktit: Emër, mbiemër \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, Shqipëri  
Tel./Fax.: \_\_\_\_\_  
email: \_\_\_\_\_

Porositësi – personi i kontaktit: Emër, mbiemër \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, Shqipëri  
Tel./Fax.: \_\_\_\_\_  
email: \_\_\_\_\_

Neni 9  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rast mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj kontrate, palët do të zgjidhin ato me mirëkuptim, në të kundërt palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \_\_\_\_\_.

Neni 10  
**Të ndryshme**

1. Kontrata hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët.  
Kjo marrëveshjeje është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe. Secila kopje ka të njëjtën vlerë ligjore.

PËR POROSITËSIN

PËR SIPËRMARRËSIN

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emër, mbiemër.....

Emër, mbiemër.....

Funksioni

Funksioni

Datë: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

**VENDIM**  
**Nr.50, datë 22.11.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 19.07.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 32 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Sotiraq Gjata

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në mungesë.  
Zyra e Shërbimit Përmbarimor pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mungesë.

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të plotë të vendimit të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda



afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut (KEDNJ).

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vitore Tusha, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Kërkuesi, Sotiraq Gjata, ka kryer detyrën e specialistit në Drejtorinë e Infrastrukturës Rrugore, pranë Drejtorisë së Transportit Rrugor<sup>1</sup> në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit (MPPTT) gjatë periudhës 2003-2006. Me vendimin nr.934/2 prot., datë 6.2.2006, të Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Ministrie, kërkuesi është liruar nga shërbimi civil me arsyetimin e ristrukturimit të vendit të punës dhe, në pamundësi sistemimi, ka kaluar në listë pritjeje. Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC), mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr.378, datë 18.05.2006, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe prova.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.6807, datë 30.11.2006, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë; anulimin e vendimit nr.378, datë 18.5.2006, të KSHC-së; anulimin e vendimit nr.934/2 prot., datë 6.2.2006, të Sekretarit të Përgjithshëm të MPPTT-së; kthimin e kërkuesit në detyrën e mëparshme; detyrimin e MPPTT-së t'i paguajë kërkuesit pagën nga data 6.2.2006, kur janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, deri në zbatimin e vendimit të Gjykatës, në bazë të pagës mujore në vlerën 36 789 lekë. Gjykata e Apelit, me vendimin nr.1396, datë 16.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.6807, datë 30.11.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr.432 datë 19.2.2008, ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e vendimit nr.6807 datë 30.11.2006. Kërkuesi ka vënë në ekzekutim titullin ekzekutiv pranë Zyrës së Përmbarimit Tiranë, e cila ka regjistruar çështjen përmbarimore me nr.459/sh prot., datë 25.4.2008. Zyra e përmbarimit, me shkresën nr.9309 prot., datë 5.7.2008 "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" ka njoftuar MPPTT-në. Në datën 26.12.2008, kjo Ministri ka pranuar të ekzekutojë pjesërisht vendimin duke i paguar kërkuesit pagën për periudhën 2007-2008 në shumën 725 746 lekë, në bazë të pagës mujore prej 36 789 lekë.

4. Kërkuesi, në datën 21.4.2011, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe brenda afatit të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë nr.6807, datë 30.11.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar:

- Zyra e Përmbarimit Tiranë nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të detyruar MPPTT-në për zbatimin e vendimit objekt kërkesë.

- MPPTT-ja, duke refuzuar të ekzekutojë plotësisht urdhërimet e vendimit, i ka mohuar të drejtën e njohur me vendim gjyqësor.

<sup>1</sup> Pas ristrukturimit emërimi i institucionit ka ndryshuar në "Drejtoria e Politikave të Transportit Rrugor 7672

## II

*1. Lidhur me pretendimin e kërkuarit për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*

5. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet nr.2, datë 1.2.2011; nr.21, datë 3.6.2011; nr.35, datë 27.10.2010; nr.6, datë 6.3.2009; nr.1, datë 19.1.2009; nr.27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të diskutojë drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr.21, datë 3.6.2011; nr.1, datë 19.1.2009; nr.6, datë 6.3.2009; nr.6, datë 31.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj të drejte mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por dhe veprimet konkrete të organeve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*shih vendimet nr.1, datë 19.1.2009; nr.6, datë 6.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutim mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr.43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e debitorit, kreditorit, por edhe të organeve kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, nga ana e tij duhet të përdoren të gjitha procedurat e parashikuara nga e drejta e brendshme. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, ato kanë detyrimin të sigurojnë progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme, edhe në ato sisteme ligjore ku zbatohet parimi se iniciativa procedurale u takon palëve (*shih vendimin nr.1, datë 19.01.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

### *i) Kompleksiteti i çështjes*

6. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin plotësisht të titullit ekzekutiv brenda një afati të arsyeshëm, kthimin e kërkuarit në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pjesës së mbetur të pagës nga data 26.12.2008 e në vazhdim. Nga tërësia e rrethanave faktike, rezulton se përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar MPPTT-së disa herë me shkresë për të kërkuar ekzekutimin vullnetar. Me shkresën nr.9309 prot., datë 5.7.2008 “Lajmërim për ekzekutimin vullnetar”, gati tre muaj pas regjistrimit të kërkesës ka njoftuar MPPTT-në, duke e vënë në dijeni se, në rast të mosekzekutimit të detyrimit brenda 10 ditëve, do të fillonte ekzekutimin e detyrueshëm dhe nëse do të refuzonte ose nuk do të plotësonte urdhërimet sipas dispozitivit të vendimit të formës së prerë, MPPTT-ja do të gjobitej deri në 50 000 lekë, si dhe do të paraqitej kallëzim penal sipas nenit 320 të Kodit Penal. Në datën 5.9.2008, MPPTT-ja është vënë në dijeni lidhur me vendimin për ekzekutimin e detyrueshëm. Në datën 26.12.2008, datë në të cilën MPPTT-ja ka përmbushur një pjesë të detyrimit financiar, Zyra e Përmbarimit ka vënë në dijeni kërkuarin, si kreditor, përmes urdhrorit për kalimin në llogari bankare të shumës 725 746 lekë. Gjithashtu, kjo zyrë i ka kërkuar MPPTT-së disa herë të tjera ekzekutimin e vendimit dhe shlyerjen e detyrimit me shkresat nr.16679



prot., datë 2.11.2009; nr.735 prot., datë 18.1.2010; nr.428/sh, datë 29.1.2010; nr.428/sh, datë 14.7.2011, por nuk ka pasur asnjë përgjigje nga institucioni përkatës.

7. Për sa më sipër, Gjykata nuk e vlerëson çështjen komplekse as nga pikëpamja e fakteve, dhe as nga pikëpamja e ligjit, që mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara me këtë qëllim nga ligji.

*ii) Sjellja e kërkuarit*

8. Për sa i përket sjelljes (veprimeve) së kërkuarit, Gjykata vlerëson se ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

*iii) Sjellja e autoriteteve publike*

9. Gjykata vlerëson se në këtë drejtim duhet të shqyrtohet sjellja e secilit autoritet të përfshirë në këtë proces, Zyrës së Përmbarrimit dhe MPPTT-së.

10. Përmbarruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është pajisur me mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Pretendimet e përmbarruesit gjyqësor se MPPTT-ja nuk u përgjigjet më shkresave zyrtare të Zyrës së Përmbarrimit nuk përbën justifikim të arsyeshëm për të ndërprerë veprimet përmbarrimore dhe përmbushjen e plotë të detyrimeve të përcaktuara në vendim. Gjykata vlerëson se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin private apo publike, duhet të përgjigjen njëloj (*shih vendimin nr.21, datë 3.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me sjelljen e debitorit, MPPTT-së, si autoriteti kryesor përgjegjës për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, rezulton se në datën 26.12.2008, ka përmbushur pjesërisht detyrimin financiar ndaj kreditorit në shumën 725 746 lekë. Nga ky moment e në vijim nuk rezulton të jetë ndërmarrë asnjë veprim tjetër për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në vendim, që kanë të bëjnë me kthimin e kërkuarit në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pjesës së mbetur të pagës, nga data 26.12.2008 e në vazhdim. Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim, debitori, me marrjen dijeni të vendimit të formës së prerë, duhet të merrte masat për ekzekutimin e plotë të detyrimeve që i ishin ngarkuar në favor të kërkuarit/kreditor.

12. Gjykata konstaton se Zyra e Përmbarrimit Tiranë nuk ka pasur pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin dhe se përmbarruesi gjyqësor nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshme procedurale me qëllim përmbushjen e detyrimeve, të parashikuara nga neni 606 i Kodit të Procedurës Civile, çka do të bënte të mundur ekzekutimin e plotë dhe brenda afatit të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë nr.6807, datë 30.11.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Zyra e Përmbarrimit Tiranë, si organ kompetent i ngarkuar me zbatimin e vendimit të formës së prerë, nuk ka ushtruar kompetencat e përcaktuara nga ligji për zbatimin e këtij vendimi dhe, për pasojë, ka cenuar të drejtën e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim, Zyra e Përmbarrimit dhe MPPTT-ja, i kishin mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim të ekzekutimit plotësisht vendimin. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata çmon se nuk ka arsye të bazuara, që justifikojnë mosrealizimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Në përfundim, Gjykata vlerëson se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr.6807, datë 30.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Petrit Pllaçi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr.114, datë 16.11.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DITEKO” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET NË LUMIN “ZALLI I OKSHTUNIT”: “BOROVË”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TËRNOVË”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Diteko” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Diteko” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et në lumin “Zalli i Okshtunit ”: “Borovë” me fuqi 1,921 MW, “Zabzun” me fuqi 0,301 MW, “Sebisht” me fuqi 2,835 MW, “Prodan 1” me fuqi 0,38 MW, “Prodan 2” me fuqi 0801 MW, “Okshtun ekologjik” me fuqi 0,45 MW, “Ternovë” me fuqi 0,921 MW, “Okshtun” me fuqi 10 MW, “Lubalesh 1” me fuqi 4,6 MW, “Lubalesh 2” me fuqi 5,1 MW dhe “Gjoricë” me fuqi 4,18 MW, për një periudhë 30-vjeçare.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.115, datë 16.11.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DITEKO” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Diteko” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DITEKO” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Diteko” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr.116, datë 16.11.2011**

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR “HEC-ET NË LUMIN ZALLI I OKSHTUNIT” : HEC-ET “BOROVË”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVË”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICË” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “II”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe neneve 6, 7 pikat 1 e 2 dhe nenit 9 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme” të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Diteko” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec-et “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë” si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Diteko” sh.p.k., është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si më poshtë:

Neni 7, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Neni 7, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI :**

1. Të kualifikojë impiantin prodhues për hec-et: “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani





**VENDIM**  
**Nr. 117, datë 16.11.2011**

**MBI ANKANDIN MUJOR TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT PËR MUAJIN DHJETOR 2011**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të “Modelit të tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “KESH sh.a.”, lidhur me alokimin e kapaciteteve për muajin dhjetor 2011,

Konstatoi se:

KESH sh.a., mund të përballlet me një situatë të përkeqësimit të kushteve hidroenergjetike për shkak të një thatësire të tejzgjatur, ç’ka do të vështirësonte mbulimin e nevojave me energji elektrike të konsumatorëve tariforë,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Ankandi i alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit për muajin dhjetor 2011, të kryhet vetëm për pjesën e mbetur të kapaciteteve pas sigurimit të nevojave të shoqërisë KESH sh.a. në përputhje me kërkesën e paraqitur nga kjo kompani për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit për muajin dhjetor.

2. OST sh.a. të sigurojë alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit për muajin dhjetor për nevoja të KESH sh.a., duke përfshirë edhe kapacitetet e pashfrytëzuara nga “CEZ shpërndarje” nga të drejtat e siguruara.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a. dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**KËRKESE**

Kërkuesi Agur Arapaj, i biri i Lutfiut dhe i Hajdines, i datëlindjes 1.1.1967, lindur dhe banues në fshatin Martin, të komunës Levan të Fierit, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Xheladin Arapaj, i biri i Lutfiut dhe i Hajdies, i datëlindjes 25.10.1963.

**KËRKUESI**  
**Agur Arapaj**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.12.2011  
Doli nga shtypi më 9.12.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint  
Tiranë, 2011

Çmimi 60 lekë